



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 47/2020 regjistër (JR)  
Datë 22.10.2020

Nr. 2 i vendimit  
Datë 02.02.2023

**V E N D I M**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Sokol Çomo</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 02.02.2023, ditën e enjte në orën 13:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me sekretare gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik, Florian Ballhysa.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 264, datë 17.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Elona Toro, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neni C pika 2, neni F, pika 2 të Aneksit të Kushtetutës; si dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e kërkesat e Komisionerit Publik të paraqitura në ankim dhe në konkluzionet përfundimtare, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit objekt shqyrtimi dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Elona Toro, subjektin e rivlerësimit Elona Toro, e cila kërkoi lënien në fuqi të vendimit, dëgjoi gjyqtaren relatore Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Elona Toro (Stavri), (në vijim “subjekti i rivlerësimit), në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, ushtronte detyrën e gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe për shkak të parashikimeve të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, (në vijim “Komisioni”), për subjektin e rivlerësimit administroi raportet e vlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar pranë Komisionit raportin<sup>1</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit dhe vlerësimit të pasurisë së subjektit Elona Toro (Stavri), me anë të të cilit në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja i ka përcjellë Komisionit raportin e kontrollit të figurës<sup>2</sup>, duke konstatuar, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit.

2.3 KLGj-ja, për subjektin e rivlerësimit Elona Toro, i ka përcjellë Komisionit një raport<sup>3</sup> të hollësishëm për vlerësimin e aftësive profesionale.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 264, datë 17.06.2020, në bazë të germës “a”, të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Elona Toro, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Këtë vendim, Komisioni e ka mbështetur mbi rezultatet e hetimit administrativ në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, për të cilët ka konkluduar se:

**3.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:** [...] *problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklarim dhe balanca negative e fondeve në vlerë relativisht të vogël, nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se në asnjë rast pasaktësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara, si më sipër, nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut të drejtësisë. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Elona*

<sup>1</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 04.04.2018.

<sup>2</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.09.2019.

*Toro ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

**3.2 Për kriterin e kontrollit të figurës:** *Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe të integritetit të subjektit të rivlerësimit Elona Toro, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.*

**3.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:** *Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale, apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

### **III. Shkaqet e ankimit**

4. Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 264, datë 17.06.2020, të Komisionit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Elona Toro.
5. Komisioneri Publik ka parashtruar në ankim se nëpërmjet këtij mjeti procedural, në respektim të kërkesave kushtetuese e ligjore për rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, në mbrojtje të interesit publik, synon kontrollin e vendimit nr. 264, datë 17.06.2020, të Komisionit nga ana e Kolegjit. Në ankim, Komisioneri Publik evidenton nevojën e hetimit të mëtejshëm të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe interesave privatë të saj, të personave të lidhur, të personave të tjerë të lidhur me të, për çështje që sipas tij janë hetuar në mënyrë të paplotë nga Komisioni ose për të cilat ky hetim mungon, si dhe kryerjen e një analize të re financiare, me qëllim justifikimin bindshëm të burimeve të ligjshme të krijimit të pasurive me të ardhura të ligjshme, sipas urdhërimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
6. Referuar përmbajtjes së ankimit të Komisionerit Publik, rezulton se çështjet e ngritura adresohen vetëm në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, të cilat paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

**6.1** Për pasurinë apartament, me sip. 112,7 m<sup>2</sup>, ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë, Komisioneri Publik, lidhur me burimet e financimit të kësaj prone, pretendon se prej Komisionit nuk është kryer një hetim dhe analizë e plotë në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe për këtë kërkon prej Kolegjit të verifikojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie lidhur me:

- i. Shumat prej 6.000 USD dhe 4.000 USD të përfituara më 31.07.2009 nga subjekti prej babait të saj, K. S., të tërhequra nga llogaritë bankare të këtij të fundit, duke kërkuar rishikimin e kufijve kohorë të analizës financiare, si dhe përfshirjen brenda tyre të të gjitha investimeve të bëra nga personi tjetër i lidhur, babai i subjektit.

- ii. Shumën prej 39.200 euro<sup>4</sup>, përfituar me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.09.2009, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe babait të saj, K. S.
- iii. Shumën prej 45.000 euro të marrë si hua nga personi tjetër i lidhur A. Ll., sipas kontratës së huas nr. {\*\*\*}, datë 23.07.2008, për të cilën duhet të kryhet një analizë e plotë financiare për të identifikuar qartë mundësinë e huadhënësit për të krijuar me burime të ligjshme këtë shumë.

**6.2** Në analizën financiare të kryer nga Komisioni, në funksion të burimit të ligjshëm të shumës së dhuruar subjektit prej 800.000 lekësh për periudhën 2009-2016, nuk është marrë në konsideratë zëri i investimeve të kryera nga personi tjetër i lidhur, babai i saj, që janë depozitat bankare të krijuara prej tij në një vlerë prej 1.390.198<sup>5</sup> lekësh (në vitet 2014-2016).

**6.3** Në analizën e kryer nga Komisioni, mungon analiza e burimeve financiare të prindërve të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, për të justifikuar dhurimet gjatë periudhës 2010-2016, në shifrën 3.357.960 lekë, në të cilën përfshihet dhe dhurimi i shumës prej 10.000 eurosh në vitin 2011, personit të lidhur për blerjen nga shoqëria e ndërtimit e një vendparkimi (në vlerën 12.000 euro).

**6.4** Analiza ekonomike e kryer nga Komisioni për periudhën 2003-2016, nga e cila ka rezultuar se subjekti është me diferencë negative vetëm për vitet 2012 dhe 2015 (në shumën totale (-) 370.165 lekë, nuk është e plotë, pasi nuk është hetuar për të gjithë elementët e saj. Komisioneri Publik pretendon se në gjendjen që janë aktet subjekti dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet edhe për vitet 2014 dhe 2016 dhe, për këtë qëllim, kërkon kryerjen e një hetimit të plotë nga ana e Kolegjit.

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

##### **A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit**

##### *a) Juridiksioni i Kolegjit*

7. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

##### *b) Legjitimimi i ankuesit*

8. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>4</sup> Shuma nga shitja e apartamentit ishte 5.800.000 lekë, nga të cilat 5.418.944 lekë është vlera e mbetur pas pagesës së tatimit mbi të ardhurat, e cila e konvertuar në euro është 39.210 euro.

<sup>5</sup> Kjo vlerë ka të përfshirë dhe interesat e përfituara të cilat në fund të periudhës që analizohet nuk janë maturuar, në këto kushte vlera e parave të investuara në analizën e Kolegjit është marrë duke mos konsideruar interesat, por vetëm vlerën e principalit (në shumën 1.374.560 lekë).

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

9. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 264, datë 17.06.2020, të Komisionit, duke qenë se është ushtruar nga Komisioneri Publik, u zhvillua në seancë gjyqësore publike.  
Përgjatë seancave gjyqësore, Komisioneri Publik, në mbështetje të ankimit të tij, ka kundërshtuar vendimin e Komisionit në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, duke kërkuar nga Kolegji kryerjen e hetimeve të mëtejshme, rezultatet e të cilave mbështetën kërkimin përfundimtar të tij për një vlerësim të ndryshëm nga Komisioni të këtij kriteri. Subjekti i rivlerësimit Elona Toro ka prapësuar pretendimet e Komisionerit Publik, duke analizuar në mbështetje të këtyre prapësimeve, provat e paraqitura prej saj përgjatë hetimit administrativ dhe shqyrtimit gjyqësor të çështjes.
10. Në përgjigje të kërkimeve të Komisionerit Publik dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, mbështetur në parashikimet e nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30, 32, 33 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji, me vendim të ndërmjetëm të trupit gjykues, çeli hetimin gjyqësor duke marrë në cilësinë e provës, për nevoja të hetimit gjyqësor, aktet e paraqitura në Kolegj nga vetë subjekti i rivlerësimit.  
Me qëllim shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik, ndaj vendimit nr. 264, datë 17.06.2020, të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit, në zbatim të vendimit të ndërmjetëm të marrë në seancën gjyqësore të datës 05.12.2022, vendosi të kryejë një analizë financiare paraprake. Kjo analizë paraprake u hartua nga Kolegji, duke reflektuar në terma financiarë kërkimet e ankimit të Komisionerit Publik, të dhënat që vinin nga aktet e depozituara në fashikullin e hetimit administrativ, si dhe gjatë gjykimit, prej subjektit të rivlerësimit e të marra në cilësinë e provës, pa bërë një vlerësim për vlerën e tyre provuese, proces i cili do të kryhej më pas në marrjen e vendimit përfundimtar.
11. Në Kolegj, pas regjistrimit të çështjes objekt gjykimi, janë administruar denoncime nga publiku që i adresoheshin subjektit të rivlerësimit. Denoncimet e sjella nga {\*\*\*}<sup>6</sup>, {\*\*\*}<sup>7</sup>, si dhe denoncimet me emër denoncuesve E. T.<sup>8</sup> dhe A. T.<sup>9</sup>, Kolegji ia vuri paraprakisht në dispozicion subjektit të rivlerësimit, para fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Denoncimet e tjera të paraqitura në emër të shtetasve E. T. dhe G. L., Kolegji i verifikoi në kuptim të përcaktimeve të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe pasi konstatoi se nuk ekzistonin shtetas të regjistruar në regjistrin e gjendjes civile të Republikës së Shqipërisë me këto gjeneralitete, si dhe vërejti se përmbajtja e këtyre denoncimeve ishte pothuajse e njëjtë e nuk paraqiste të dhëna konkrete të cilat mund të ndikonin në rivlerësimin kalimtar të subjektit të rivlerësimit, vendosi të mos i marrë ato në shqyrtim.
12. Për këto denoncime, subjekti i rivlerësimit, në seancën gjyqësore të datës 05.12.2022, paraqiti shpjegimet e saj. Subjekti prapësoi se nga verifikimet e kryera prej saj, denoncimet në emër të denoncuesve E. T., A. T. dhe {\*\*\*}, rezultojnë të jenë sjellë nga adresa elektronike që nuk identifikohen, dhe se këta shtetas nuk i ka pasur si palë ndërgjyqëse në asnjë proces gjyqësor e, në këto kushte, nuk ka situata për të shpjeguar apo qartësuar lidhur me sjelljen e saj gjyqësore ndaj tyre. Ndërsa në lidhje me denoncimin e sjellë nga {\*\*\*}, e cila adresonte problematika për gjykimin e çështjes të së pandehurit J. K., subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet, si dhe aktet bashkëlidhur në mbështetje të tyre.
13. Kolegji, pasi u njoh me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit Elona Toro, lidhur me denoncimet e administruara për të në Kolegj, analizoi dhe shqyrtoi shpjegimet e dhëna prej

<sup>6</sup> E regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 27.10.2021.

<sup>7</sup> E regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 11.08.2021.

<sup>8</sup> E regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 07.11.2022.

<sup>9</sup> E regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 14.09.2021.

saj dhe aktet e paraqitura në mbështetje të këtyre shpjegimeve, e konsideroi të ezauruar fazën e verifikimit të denoncimeve dhe vlerësoi se informacioni i përcjellë nëpërmjet tyre nuk plotësonte kriteret e parashikuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016 e nuk krijonte bindjen për shkeljet ligjore të pretenduara se janë kryer nga subjekti, për pasojë vendosi të mos i konsiderojë ato si me peshë në marrjen e vendimit dhe zgjidhjen e çështjes.

14. Në përfundim të hetimit gjyqësor, Kolegji vlerësoi shkaqet e ngritura në ankim dhe pretendimet përfundimtare të Komisionerit Publik, duke analizuar e çmuar të gjitha provat që gjendeshin në fashikullin e hetimit administrativ të krijuar nga Komisioni, si dhe ato të cilat u morën gjatë procesit gjyqësor dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor prej palëve.

**B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji**

**i. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

15. Kolegji mori në shqyrtim dhe ia nënshtrroi analizës së tij shkaqet e ankimit, mbi të cilat u mbështet Komisioneri Publik në përfundim të procesit gjyqësor, si arsye për të cilat duhej të vendosej ndryshimi i vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi. Për pasojë, Kolegji konsideroi se Komisioneri Publik hoqi dorë nga shkaqet e ankimit të cilat lidheshin me: (i) burimin e krijimit të shumës 39.200 euro, e ardhur nga shitja e pasurisë në bashkëpronësinë e subjektit të rivlerësimit dhe të atit të saj, i ndjeri K. S., pasi Komisioneri Publik në parashtrimet e seancës gjyqësore të datës 05.12.2022, për këtë shkak ankimor, nënvizoi evoluimin e jurisprudencës së Kolegjit, lidhur me sa është kërkuar në paragrafin 22 e në vijim të ankimit, për verifikimin e ligjshmërisë së shumës së dhuruar, sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke theksuar se mbetet detyrim vlerësimi, rast pas rasti, i kësaj shtate, duke përfshirë në këtë vlerësim elementë të tillë si deklarimi i saktë, ekzistenca e burimit të ligjshëm, si dhe çdo rrethanë tjetër që shërben në verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të pasurisë; (ii) mundësitë e personit tjetër të lidhur I. T., për të dhuruar shumat e deklaruara ndër vite nga ana e subjektit të rivlerësimit, pasi Komisioneri Publik, vlerëson se, pas analizimit të akteve të depozituara mbi investimet e familjes Toro, subjekti i rivlerësimit ka provuar burimet e ligjshme të dhuruesve (familjes Toro), për të dhuruar shumat e deklaruara për periudhën 2010-2016; (iii) shkakun ankimor mbi burimet e ligjshme të personit tjetër të lidhur K. S., për të dhuruar, gjatë viteve 2008-2016, fëmijëve të subjektit të rivlerësimit shumat e deklaruara nga subjekti, gjithsej në vlerën prej 800.000 lekësh, pasi Komisioneri Publik ka vlerësuar se nga aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore publike rezultuan rrethana që dëshmojnë një marrëdhënie të ngushtë të karakterit familjar të personit tjetër të lidhur K. S. me Th. Ç., për krijimin e depozitave pranë BKT-së, duke u çmuar se plotësohen nevojat e hetimit për këtë shkak ankimi

**15.1** Kolegji konstaton se Komisioneri Publik, i cili është titullar i së drejtës për të paraqitur ankim, mbështetur në shkaqet që e përbëjnë atë, në përfundim të hetimit gjyqësor e pasi analizoi provat e paraqitura, ka vlerësuar se shkaqet e evidentuara më sipër të prezantuara si të tilla në ankim në mungesën e një hetimit të plotë morën zgjidhje nga hetimi gjyqësor dhe u konsideruan se nuk përbëjnë një argument/arsye për cenimin e vendimit të Komisionit. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se këto pretendime nuk duhet të jenë pjesë e vlerësimit të trupit gjykues, për sa kohë që kërkimi i Komisionerit Publik për ndryshimin e vendimit nuk mbështetet në to, por në shkaqet e tjera të ankimit.

**15.2** Në këto rrethana, në arsyetimin në vijim, Kolegji do të analizojë dhe shqyrtojë ato shkaqe ankimi, të cilat mbetën në vlerësimin e Komisionerit Publik, si arsye mbi të cilat i kërkohet gjykatës ndryshimi i vendimit.

16. Kolegji mori në shqyrtim pretendimin e Komisionerit Publik të paraqitur në ankim dhe të konfirmuar, si të tillë, edhe në parashtrime e në konkluzionet përfundimtare se për pasurinë

apartament, me sip.112,7 m<sup>2</sup>, ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë, prej Komisionit nuk është kryer një hetim dhe analizë e plotë në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe për këtë pasuri kërkon prej Kolegjit të verifikojë:

a) Mundësinë e babait të subjektit të rivlerësimit, si person tjetër i lidhur, për të krijuar me burime të ligjshme shumat prej 6.000 eurosh dhe 4.000 USD, gjendje në depozitat në NBG<sup>10</sup>, të cilat subjekti i ka përfituar si dhurim prej tij, duke kërkuar rishikimin e kufijve kohorë të analizës financiare, si dhe përfshirjen në të si shpenzim të të gjitha investimeve të bëra prej tij.

b) Mundësinë e huadhënësit A. Ll., si person tjetër i lidhur, për të krijuar me burime të ligjshme shumën prej 45.000 eurosh të marrë si hua nga bashkëshorti i subjektit, sipas kontratës së huas nr. {\*\*\*}, datë 23.07.2008.

17. Lidhur me verifikimin e burimit të krijimit të shumave prej 6.000 euro dhe 4.000 USD dhuruar subjektit prej babait të saj, në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, është konkluduar se: *Si përfundim, referuar analizës së kryer dhe vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe fakteve të pasqyruara, si më sipër, bazuar në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, si dhe në mungesë të indicieve të besueshme për fshehje pasurie të subjektit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se personi tjetër i lidhur (babai i subjektit të rivlerësimit) ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e shumave 6.000 euro dhe 4.000 USD të dhëna në favor të subjektit, me qëllim kryerjen e pagesës së këstit të parë për blerjen e apartamentit objekt hetimi.*

17.1 Ndryshe nga ky qëndrim i Komisionit, Komisionerit Publik ka pretenduar në ankim se është e nevojshme që prej Kolegjit të verifikohet mundësia e babait të subjektit të rivlerësimit, si person tjetër i lidhur, për të krijuar me burime të ligjshme shumat e mësipërme, gjendje në depozitat në NBG.

17.2 Komisioneri Publik në ankim, por edhe në parashtrimet gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, kërkoi që babai i subjektit si person tjetër i lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, t'i nënshtrohej analizës për verifikimin e mundësisë së tij për të krijuar me burime të ligjshme shumat prej 6.000 eurosh dhe 4.000 USD, të dhuruara subjektit, duke pretenduar për rishikimin e metodologjisë së aplikuar në analizën financiare të Komisioni, lidhur me: (i) konsiderimin e periudhës kohore për krijimin e këtyre depozitave, shkurt 2005<sup>11</sup> deri në nëntor 2008; (ii) përfshirjen në analizë si të ardhura të babait të subjektit, vetëm ato për të cilat provohet ligjshmëria e krijimit të tyre; (iii) përfshirjen si investim/shpenzim në analizë të çdo pasurie të dokumentuar se është krijuar prej babait të subjektit përgjatë kohës së krijimit të depozitave.

17.3 Në analizë të pretendimit të Komisionerit Publik, për sa më lart, Kolegji konstatoi se situata faktike, lidhur me krijimin e këtyre shumave, paraqitet si vijon.

17.4 Në vendimin objekt shqyrtimi rezulton se Komisioni me të drejtë ka konsideruar si person tjetër të lidhur të subjektit, babain e saj, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke qenë se shumat 6.000 euro dhe 4.000 USD, të cilat i dispononte si likuiditete në depozita bankare në korrik të vitit 2009, ia ka dhuruar subjektit të rivlerësimit. Nisur nga këto të dhëna, Komisioni ka kryer analizën financiare për të verifikuar mundësinë e tij për krijimin e këtyre shumave me burime të ligjshme, duke nisur nga viti 1999, deri në momentin e dhurimit të shumave subjektit në korrik 2009.

17.5 Komisioneri Publik ka pretenduar se analiza, për sa më sipër, duhet kryer jo duke iu referuar momentit të përfitimit të shumave si dhurim nga subjekti, në korrik të vitit 2009, por

<sup>10</sup> Sot "Banka Amerikane e Investimeve" (ABI Bank).

<sup>11</sup> Pasi rezulton se në periudhën tetor 2004-janar 2005 nga personi tjetër i lidhur K. S. janë kryer investime në pasuri të paluajtshme: apartament banimi, me sipërfaqe 78 m<sup>2</sup>, me vlerë 51.000 euro, në Tiranë.

duhet kryer duke konsideruar momentin e krijimit të tyre, nëpërmjet derdhjes së likuiditeteve prej personit tjetër të lidhur në llogaritë bankare, të cilat përmbillen në nëntor 2008.

**17.6** Për shumat e përfituara si dhurim nga babai, subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 ka deklaruar se ka marrë prej babait të saj shumat e disponuara prej tij në llogaritë bankare në euro dhe USD, në NBG, në vlerat 6000 euro dhe 4000 USD, ndërsa në deklaratën *vetting*, subjekti, në funksion të deklarimit të burimeve të financimit të apartamentit, nuk ka specifikuar destinimin e shumave 6.000 euro dhe 4.000 USD, por ka sqaruar gjatë hetimit administrativ se këto shuma kanë shkuar për pagesën e këstit të parë të apartamentit me sip.112,7 m<sup>2</sup>, në Tiranë.

**17.7** Nga analizimi i të dhënave bankare të NBG-së, të administruara në fashikullin e hetimit administrativ rezulton se: (i) llogaria në USD është hapur nga babai i subjektit në datën 06.09.2007, tek e cila janë depozituar 1.900 USD, me afat maturimi 1-vjeçar. Në datën 20.11.2008, ai ka depozituar shumën 2.000 USD, me afat maturimi 1-vjeçar (tërhequr totalisht shuma 3.960 USD, në datën 20.07.2009); (ii) në llogarinë në euro, në datën 20.9.2007, babai i subjektit ka depozituar shumën 4.000 euro, me afat maturimi 1-vjeçar (tërhequr pjesërisht në datën 18.07.2008 dhe ridepozituar më 20.11.2008), më pas kjo depozitë është mbyllur, në datën 21.07.2009.

**17.8** Kolegji, ashtu si edhe Komisioneri Publik, për sa i përket kufijve kohorë, në të cilën do të shtrihet analiza financiare për babanë e subjektit të rivlerësimit, për të verifikuar burimin e ligjshëm të krijimit të shumave prej 6.000 euro dhe 4.000 USD, çmoi të drejtë kryerjen e saj duke filluar nga shkurti 2005<sup>12</sup> deri në momentin kur këto fonde janë kredituar përfundimisht në këto llogari, në nëntor 2008. Kolegji çmoi se versioni i analizës financiare, sipas pretendimit të subjektit për të konsideruar si kufij kohorë shkurtin e vitit 2005 deri në momentin që subjekti i kishte përfutur këto shuma, në korrik 2009, është një version, i cili nuk i përgjigjet kohës së krijimit të këtyre pasurive, por momentit të përdorimit të tyre si burim për financimin e pasurisë apartament në pronësi të subjektit. Në zbatim të shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimit nr. {\*\*\*}, datë 10.10. 2016, të Inspektorit të Lartë të Inspektoratit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, subjektet kanë detyrimin e provimit të burimit të krijimit të pasurive në momentin që ato krijohen, për pasojë, për sa kohë këto pasuri likuiditet sipas rekordeve bankare janë krijuar deri në muajin nëntor 2008, deri në atë moment duhet të analizohen edhe të dhënat financiare për personin tjetër të lidhur, në përputhje me pretendimin e Komisionerit Publik. Përdorimi i tyre, në muajin korrik të vitit 2009, kur janë tërhequr nga banka dhe i janë dhënë subjektit, nuk përkon me kohën e krijimit të tyre dhe për sa kohë subjekti i identifikon si burim, pikërisht, likuiditetet që janë gjendur në llogaritë bankare dhe jo të ardhura të tjera të krijuara prej babait të saj edhe vlerësimi për to çmohet i drejtë të bëhet deri në momentin kur ato shuma janë kredituar prej personit të lidhur në llogaritë e tij, të identifikuar prej vetë subjektit të rivlerësimit.

**17.9** Subjekti i rivlerësimit, lidhur me analizën financiare të babait të saj, përgjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, pretendoi se analiza paraprake e kryer nga Kolegji, duke reflektuar pretendimet e Komisionerit Publik, nuk është e saktë, pasi situata financiare e babait të saj ka qenë më e favorshme, pasi ai përveç të ardhurave nga pensionet, (e pleqërisë dhe ai suplementar), ka siguruar të ardhura edhe nga dhënia me qira e një apartamenti në pronësi të tij në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka

---

<sup>12</sup> Kjo pasi deri në janar 2005 nga personi tjetër i lidhur K. S. janë kryer investime në pasuri të paluajtshme, apartament banimi, me sipërfaqe 78 m<sup>2</sup>, me vlerë 51.000 euro, në Tiranë, transaksion i finalizuar me kontratën e shitjes në vitin 2013, në vlerën 51.000 euro, (prej të cilave është paguar deri në janar 2005 shuma prej 46.000 euro), për blerjen e të cilit ka marrë hua si nga e bija dhe nga shtetasi A. LL., sipas deklarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ.



paraqitur përgjatë hetimit administrativ në Komision deklaratën noteriale të E. T.<sup>13</sup>, tek e cila ai deklaroi se ka pasur me qira apartamentin në pronësi të subjektit dhe të babait të saj, për periudhën 01.10.2006-31.08.2009, në funksion të së cilës Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, (në vijim “DRT Tiranë”), me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.10.2019, informon se E. T., me NIPT {\*\*\*}, ka kryer pagesa të tatimit mbi qiranë. Gjithashtu, gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit pretendoi se babai i saj ka përfituar të ardhura në vlerën prej 220.000 lekësh, nga dhënia me qira e kësaj banese E. Gj., për periudhën 01.01.2005-01.10.2016. Për këtë të ardhur, DRT-ja Tiranë, me të njëjtën shkresë që konfirmon pagesat e detyrimeve tatimore nga qiramarrësi E. T., informon se për qiramarrësin E. Gj., nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar pagesat e tatimit në burim.

**17.10** Në mbështetje të pretendimit, subjekti i rivlerësimit paraqiti si provë pagesat e energjisë elektrike të apartamentit të babait të dhënë me qira, të cilat sipas saj tregojnë për konsum të energjisë elektrike, pra, për përdorim të tij nga qiramarrësit, pasi në të njëjtën periudhë, (janar 2005-tetor 2006), babai i saj tashmë banonte në apartamentin e ri në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, apartament i cili figuronte, gjithashtu, me konsum të energjisë elektrike për të njëjtën periudhë.

**17.11** Kolegji, lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, ashtu si edhe Komisioni, ka konsideruar të drejtë përfshirjen në analizë vetëm të të ardhurave të krijuara nga marrëdhënia e qirasë me E. T., për të cilat provohet pagesa e detyrimeve tatimore si të ardhura, që përmbushin kërkesat e nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Të ardhurat e pretenduara se janë siguruar prej marrëdhënies së qirasë me E. Gj., ndonëse krijojnë besueshmëri për krijimin e tyre, përveç se deklarimit përkatës në DPV-në e vitit 2005, por edhe në këndvështrim të faktit që duket se provohet nga faturimet për konsum të energjisë, se ai apartament është banuar prej një njësie familjare në kohën e pretenduar, nuk u konsideruan si të ardhura në analizën financiare, për sa kohë për to nuk u provua pagimi i detyrimeve tatimore, sipas kërkesave të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

**17.12** Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik, sipas së cilit kërkon përfshirjen si shpenzim në analizën financiare të personit tjetër të lidhur të të gjitha investimeve që ai rezulton se ka kryer, të cilat në rastin konkret lidhen me përfshirjen si shpenzim të shumës 270.000 lekë gjendje në një depozitë në ABI Bank të krijuar në nëntor të vitit 2008, Kolegji analizon sa vijon.

**17.13** Kolegji në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në referim të jurisprudencës së deritanishme<sup>14</sup>, lidhur me interpretimin e kësaj dispozite, nuk e konsideroi si shpenzim me të cilin duhej ngarkuar analiza financiare e personit tjetër të lidhur vlerën prej 270.000 lekësh, të ndodhur në llogarinë bankare në NBB, (sot Banka Amerikane e Investimeve), në emër të tij. Kolegji vlerësoi se për personin tjetër të lidhur analiza financiare duhet shtrirë në drejtim të verifikimit të mundësisë për të krijuar me të ardhura të ligjshme pasurinë, e cila është objekt i marrëdhënies së dhurimit, në këtë rast shumat respektive të përshkruara më lart. Pjesë e kësaj analize do të jenë edhe shpenzimet e kryera prej tij për të përballuar kostot e jetesës, si një e dhënë bazike e përdorur tashmë për analizimin e mundësisë financiare të personave të tjerë të lidhur, sipas jurisprudencës së Kolegjit. Ky vlerësim konsiderohet se përmbush kriteret e një vlerësimi të arsyeshëm e proporcional, lidhur me mundësitë e personave të tjerë të lidhur, duke krijuar një panoramë të mjaftueshme për marrjen e një vendimi, lidhur me burimet e ligjshme të krijimit të pasurive të dhëna hua apo dhuruar sipas rastit.

<sup>13</sup> Nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 18.09.2019.

<sup>14</sup> Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit (JR) 15/2019, datë 17.06.2019 dhe (JR) 20/2019, datë 31.07.2019.

**17.14** Arsyetimi i bërë më lart mbështetet në rastin konkret edhe nga një rrethanë faktike që lidhet me të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e apartamentit të personit tjetër të lidhur, përgjatë vitit 2005-2006, të cilat nuk u konsideruan si të ligjshme për shkak të mungesës së pagimit të detyrimeve tatimore, por që duket se i japin kuptim metodologjisë së përdorur nga Kolegji, për vlerësimin e burimeve të krijimit të pasurive të personave të tjerë të lidhur, duke qenë se mbështet hipotezën e pasjes së burimeve të tjera që mbeten jashtë kontrollit të këtij procesi, për rrethana që lidhen me statusin e personave të tjerë të lidhur.

**17.15** Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dhe debatit mes palëve, lidhur me ngarkimin me shpenzime të personit tjetër të lidhur për të gjithë shumën e shlyer huadhënësit A. Ll. prej tij, Komisioneri Publik konkludoi se provohet pretendimi i subjektit se detyrimi financiar i K. S. kundrejt A. Ll. duket të jetë shlyer/paguar nga personi i lidhur me subjektin A. T., rrjedhimisht gjendet i mbështetur dhe pretendimi i subjektit mbi konsiderimin si shpenzim i K. S., vetëm të shumës prej 120.000 lekësh, për periudhën shkurt 2005-nëntor 2008, për shlyerjen e detyrimit ndaj A. Ll. Kolegji, pasi analizoi shpjegimet e dhëna prej subjektit të rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, lidhur me përdorimin e bonove të thesarit në emër të babait të saj në vlerën 630.000 lekë, ndau të njëjtin qëndrim me Komisionerin Publik lidhur me këtë zë të analizës financiare dhe përfshiu në të diferencën prej 510.000 lekësh si të ardhur dhe shumën prej 120.000 lekësh si shpenzim për periudhën e marrë në shqyrtim.

**17.16** Mbi bazën e konkluzioneve të mësipërme, Kolegji kreu analizën financiare<sup>15</sup> të babait të subjektit të rivlerësimit, për periudhën shkurt 2005-nëntor 2008, për të verifikuar mundësinë e tij për të krijuar me burime të ligjshme shumat 6.000 euro dhe 4.000 USD të dhuruara subjektit, nga e cila rezultoi në një situatë pozitive prej (+) 43.484 lekësh.

**17.17** Në përfundim, nga analiza e mësipërme e kryer nga Kolegji, rezultoi se personi tjetër i lidhur K. S. kishte mundësi të krijonte me burime të ligjshme shumat prej 6.000 eurosh dhe 4.000 USD të vendosura në depozitat bankare deri në nëntor 2008 e, më pas, të dhuruara subjektit për t'i përdorur për pagesën e këstit të parë të pasurisë apartament të ndodhur në Tiranë, duke u përmbushur në këtë mënyrë, detyrimi që buron nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

**18** *Në drejtim të kërimit të Komisionerit Publik, për të verifikuar mundësinë e personit tjetër të lidhur A. Ll. si huadhënës, për të krijuar me burime të ligjshme shumën 45.000 euro e dhënë hua bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe e përdorur për financimin e apartamentit me sip. 112,7 m<sup>2</sup>, në Tiranë, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji analizon sa vijon.*

**18.1** Në vendimin e Komisionit, në drejtim të huadhënësit A. Ll., është konkluduar se: *Nga shqyrtimi i të dhënave financiare të mësipërme, të para në një këndvështrim tjetër, duket se vetëm të ardhurat e A. Ll., të përlogaritura nga Komisioni, për periudhën deri para dhënies së huas, janë përfaqësues rreth 5.400.000 lekë (pa përfshirë të ardhurat e përfituara prej tij për periudhën janar - mars të vitit 2010), të cilat (duke përfshirë të ardhurat e përfituara për periudhën janar - mars të vitit 2010) janë të mjaftueshme për krijimin e një shume prej rreth 40.000 eurosh<sup>39</sup>. Bazuar në parimin e proporcionalitetit, në vlerësim të informalitetit të kohës dhe të pretendimeve të huadhënësit për fitimin neto të realizuar nga aktiviteti i tij tregtar, si*

---

<sup>15</sup> *Analiza financiare e Kolegjit për personit tjetër të lidhur K. S., për periudhën shkurt 2005-nëntor 2008. Të ardhurat e periudhës në total 1.958.060 lekë. Të ardhura nga pensioni në shumën 761.418 lekë. Likuiditete nga Bonot e Thesarit në shumën 630.000 lekë. Të ardhura nga qiradhënia në shumën 520.000 lekë. Interesa nga depozitat në shumën 46.642 lekë. Shpenzime të periudhës në total 1.914576 lekë. Dhurim nipit dhe mbesës në shumën 150.000 lekë. Dhurim subjektit të rivlerësimit 6.000 euro dhe 4.000 USD ekuivalent me 1.073.0383 lekë. Pagesë shlyerje detyrimi ndaj A. Ll. në shumën 120.000 lekë. Shpenzime jetese sipas të dhënave të INSTAT në shumën 571.193 lekë. Rezultati (Të ardhura – Shpenzime) = 43.484 lekë.*

*dhe duke konsideruar se shpenzimet e tij janë mbuluar nga familjarët me të ardhurat nga shitja apo dhënia me qira e pasurive të paluajtshme, duket se ka pasur burime financiare të ligjshme për dhënien e huas në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të mbuluara me të ardhurat e përfituara prej tij [...].*

**18.2** Komisioneri Publik, në ankim, përgjatë gjykimit dhe në konkluzionet përfundimtare, ka pretenduar se nuk provohet krijimi me burime të ligjshme i shumës prej 45.000 eurosh, të dhënë hua në vitin 2009 bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga A. Ll., pasi në momentin e dhënies së kësaj huaje, huadhënësi rezultoi me një balancë negative në vlerën (-)3.125.100 lekë. Komisioneri Publik kontestoi analizën financiare të bërë nga Komisioni për personin tjetër të lidhur A. Ll., duke kërkuar nga Kolegji rishikimin e metodologjisë së kryerjes së analizës financiare për të kontrolluar, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, mundësinë e personit tjetër të lidhur për të krijuar shumën e dhënë hua me burime të ligjshme, duke konsideruar se: (i) në analizën e Komisionit nuk janë përfshirë investimet e bëra nga huadhënësi; (ii) analiza financiare e Komisionit është bërë duke përfshirë të ardhurat e gjithë familjes dhe shpenzimet vetëm për një person, ndërkohë që huadhënësi kishte një familje me 6 persona.

**18.3** Subjekti i rivlerësimi, gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, i prapësoi pretendimet e Komisionerit Publik në drejtim të analizës financiare të bërë nga Komisioni duke pretenduar se:

i) Lidhur me kostot e jetesës së familjes së huadhënësit, prindërit, bashkëshortja dhe dy fëmijët e mitur të huadhënësit nuk kanë pasur asnjë detyrim ligjor, në kuptim të nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të tyre, pasi nuk plotësojnë kriteret ligjore për t'u konsideruar si persona të tjerë të lidhur. Për këtë fakt, subjekti pretendoi se në vështrim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të asaj pasurie deri në vlerën e huas, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë *personat e tjerë të lidhur me personin tjetër të lidhur*. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se personi tjetër i lidhur me të, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, është vetëm A. Ll., i cili pa ndonjë akt të posaçëm ka menaxhuar marrëdhëniet dhe të ardhurat e krijuara nga puna/aktiviteti tregtar, shitja e pasurive apo dhënia me qira e tyre, rrethanë që përbënte një lehtësim për prindërit<sup>16</sup> e huadhënësit që janë në moshë të thyer. Në drejtim të indikatorëve financiarë të analizës së familjes Ll., subjekti i rivlerësimit shpjegoi se kjo analizë nuk mund të përkeqësohet, pasi prindërit dhe bashkëshortja e huadhënësit mbulojnë me të ardhura të ligjshme kostot e jetesës.

ii) Kolegji duhet të konsiderojë se huadhënësi A. Ll. dhe familja e tij, ndër vite, kanë siguruar të ardhura të konsiderueshme nga qiradhënia e pasurive të paluajtshme. Për të mbështetur këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj paraqiti si provë disa kontrata qiraje<sup>17</sup> të pasurive të paluajtshme të familjes së huadhënësit. Subjekti shpjegoi se

<sup>16</sup> Gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision si provë deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.10.2019, në të cilën nëna dhe e motra e A. Ll. deklarojnë ndërmjet të tjerash, pikërisht, marrëdhënien specifike mes tyre dhe dijeninë e plotë të menaxhimit të shumave të z. I. nga i biri A. Ll.

<sup>17</sup> Në seancën gjyqësore të datës 05.12.2022, subjekti i rivlerësimit si provë për qiradhënien e familjes Ll. paraqiti këto akte: (i) kontratën e qirasë së vijuar më shumë se tre vjet nga parashikimi kontraktor, me numër {\*\*\*}, datë 24.06.1996, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., lidhur midis qiradhënësve bashkëpronarë (B. A. bashkëpronar për 1/2 pjesë dhe I. Ll. bashkëpronar për 1/2 pjesë) për dhënien me qira të një magazine të artikujve sportivë në {\*\*\*}, me sipërfaqe 196 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme trualli 1,321 m<sup>2</sup>, mbi të cilën ndërtimi magazinë ka sipërfaqen 882 m<sup>2</sup> dhe me cilësinë e qiramarrësit shoqërinë "{\*\*\*}" ShPK, me vlerë mujore 590 USD, për një periudhë 3-vjeçare, me rishikim vlere pas 6 muajve të lidhjes kontratës; (ii) kontrata e qirasë, datë 05.08.1999, me vlefshmëri 16.08.1999 deri në 16.02.2000, me qiramarrës shoqërinë "{\*\*\*}", në shumën 600 USD, lidhur në cilësinë e qiradhënësit nga bashkëpronari tjetër i magazinës B. A., por që shuma e qirasë mujore ndahej 50% me 50% për secilin bashkëpronar; (iii) kontrata e qirasë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.05.2000, lidhur midis B. A. bashkëpronar për 1/2 pjesë, për dhënien me qira të sipërfaqes 400 m<sup>2</sup> magazinë, pjesë nga sipërfaqja e

këto kontrata qiraje provojnë se personi tjetër i lidhur A. Ll. ka pasur mundësi e burime financiare për të krijuar shumë më tepër sesa shuma prej 45.000 eurosh dhënë hua, si dhe parashtrori se në të gjitha rastet e marrëdhënieve të qirave të pronave të tyre, detyrimin për të paguar tatimin në burim, në kuptim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, e kishin qiramarrësit, të cilët ushtronin aktivitetin në to.

iii) Pretendimin e Komisionerit Publik se në analizën e kryer nga Komisioni për huadhënësin A. Ll. nuk janë përfshirë si shpenzim investimet që ai ka kryer deri në momentin e dhënies hua të shumës 45.000 euro, subjekti e kundërshtoi si një qëndrim jo të bazuar në përcaktimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por edhe jo të bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, e cila ka mirëpërcaktuar tashmë se objekt kontrolli në rastet e verifikuara të huadhënies apo të dhurimit është verifikimi i krijimit me burime të ligjshme nga huadhënësit/dhuruesit i pasurive të dhëna hua apo të dhuruara dhe jo i çdo lloj pasurie të krijuar prej tyre.

iv) Gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimi pretendoi se marzhi i fitimit të aplikuar nga Komisioni në masën 20 % të qarkullimit të aktivitetit tregtar, të huadhënësit<sup>18</sup> për periudhën 1994-2008, është në nivel shumë të ulët, pasi të gjithë indikatorët e aktivitetit tregtar që ai ushtronte janë të dhëna që dëshmojnë për fitime jo më pak se 50 % e qarkullimit vjetor. Këtë pretendim, subjekti e mbështeti në faktin se huadhënësi ka zhvilluar jo vetëm një aktivitet me natyrë tregtare në shitje mallrash, por ka vepruar edhe si agjent i shitjes së gazetave e revistave, si dhe agjent i tregtimit të biletave të lotove sportive dhe të lotarisë kombëtare, të cilat duke qenë aktivitete që nuk kërkonin shpenzim për blerje mallrash i siguronin të ardhura të larta. Në mbështetje të këtij pretendimi, gjatë gjykimit subjekti i rivlerësimit paraqiti në cilësinë e provës kontratat e bashkëpunimit<sup>19</sup> të lidhura, ndër vite, nga huadhënësi me shoqëritë e autorizuara për emetimin e biletave të lotarive kombëtare, për tregtimin e të cilave subjekti shpjegoi se: *Huadhënësi A. Ll. në xhiron e tij vjetore të deklaruar për vitet për të cilat i është bërë analiza financiare, por dhe më tej, vetëm për shitjen e biletave*

---

*përgjithshme e truallit 1321 m<sup>2</sup>, mbi të cilin ndërtimi magazinë ka sipërfaqen totale 882 m<sup>2</sup> dhe me cilësinë e qiramarrësit Sh. V., me vlerë për 6 muajt e parë 25.000 lekë/muaj dhe për periudhën në vazhdim, në vlerën 30.000 lekë/muaj, shumë e cila ndahej 50% me 50% për secilin bashkëpronar; (iv) kontrata e qirasë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.12.2001, lidhur midis B. A. bashkëpronar për 1/2 pjesë, për dhënie me qira të sipërfaqes tjetër kol. 400 m<sup>2</sup> magazinë, pjesë nga sipërfaqja e përgjithshme e truallit 1,321 m<sup>2</sup>, mbi të cilin ndërtimi magazinë ka sipërfaqen totale 882 m<sup>2</sup> dhe me cilësinë e qiramarrësit, shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, për një periudhë 2-vjeçare, me vlefshmëri 01.11.2001 deri në 01.11.2003, me vlerë 20.000 lekë/m<sup>2</sup>, shumë e cila ndahej 50% me 50% për secilin bashkëpronar; (v) qira nga dyqani i marrë nga A. T., në vlerën 20.000 - 25.000, për periudhën 1995-2007, për aktivitetin e tij privat shitje e rregullim orësh. Deklaratë noteriale, datë 21.01.2021, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., e shtetasit A. T.; (vi) shtëpia prapa {\*\*\*}, dhënë me qira B. D., në vlerën 25.000 lekë, për periudhën 1996 - 2008, pronë e cila edhe sot e kësaj dite vazhdon në marrëdhënie qiraje. Deklaratë noteriale, datë 25.1.2021, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., e shtetasit B. D..*

<sup>18</sup> Gjatë hetimit administrativ në Komision, si edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, lidhur me natyrën e aktivitetin tregtar të huadhënësit A. Ll., subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: Aktiviteti tregtar i A. Ll., sikurse kam deklaruar dhe në përgjigje të pyetësorëve, vërtetohet si nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 05.11.1993, në të cilin është vendosur: regjistrimi i kërkuarit A. Ll. si person fizik për të ushtruar veprimtarinë private në fushën: tregtimi i mallrave ushqimore, industriale, me shumicë e pakicë, materiale ndërtimi, elektronike, fruta - perime, pije alkoolike, freskuese, bimë mjekësore etj. regjistruar në organet tatimore (sot QKB) në numrin NIPT {\*\*\*} dhe Ekstrakti Historik, ku vihet re se aktiviteti i tij është zgjeruar në vitin 1997 dhe me tregtimin e librit artistik, gazetave, revistave të ndryshme si dhe të biletave e lotarive të fatit. Këto aktivitete janë ushtruar prej tij fillimisht në dyqanin po në rrugën “{\*\*\*}”, te “{\*\*\*}”, e më pas, kur ky dyqan u dha me qira, në kioskën përballë tij.

<sup>19</sup> Në seancën gjyqësore të datës 05.12.2022, subjekti i rivlerësimit si provë për të ardhurat e siguruar nga tregtimi i biletave të lotarive kombëtare paraqiti këto akte: (i) kontrata e bashkëpunimit, datë 26.09.2001, e lidhur me {\*\*\*} ShA, ku në pikën 17 të kontratës citohet se: Nga shitja e skedinave shitësi A. Ll. përfiton 7% të inkasimit total bruto mbasi zbritet TVSH dhe TLF; (ii) kontrata e vitit 2002, e lidhur me {\*\*\*} ShA, ku në pikën 15 të kontratës citohet se: Nga shitja e skedinave shitësi A. Ll. përfiton 8% të inkasimit total bruto për lotarinë totobaste dhe 5.6 % të inkasimit total bruto për lotaritë e tjera; (iii) kontrata, datë 27.08.2005, e lidhur me {\*\*\*} ShA, ku në pikën 16 të kontratës citohet se: Nga shitja e skedinave shitësi A. Ll. përfiton 6% të inkasimit bruto për lotarinë totofutboll e totogol.

*të lotove, ai është pajisur me një aparat të sistemit “off-line” (qark i mbyllur shitës - qendër), aparat ky që mbetet në pronësi të Qendrës e kontrollohej nga ata. Për këtë aktivitet, në datat limit të paracaktuara nga Qendra, pasi ai bënte dorëzimet përkatëse, për çdo shumë të grumbulluar nga shitja e skedinave, përfitonte sipas rastit përqindjen që ishte e përcaktuar në kontratat përkatëse të bashkëpunimit (që varionte 5.6% deri 8%), përqindje kjo që llogaritej mbi masën e inkasimit total bruto mbasi zbritej Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe Tatim i Lojërave të Fatit (TLF) për të cilat tatohej vetë Qendra.*

Për të evidentuar të ardhurat e siguruara nga huadhënësi prej tregtimit të lotarive kombëtare, subjekti i rivlerësimit paraqiti si provë vërtetimin e datës 14.11.2022, të lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, që provon përfitimin e shumave përkatëse përgjatë viteve 2019, 2020, 2021 dhe 2022, në total 3.498.126 lekë<sup>20</sup>, si edhe vërtetimin e datës 14.11.2022, të lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA, që provon përfitimin e shumave përkatëse në vitet 2020, 2021 dhe 2022, në total 949.668<sup>21</sup>.

v) Gjithashtu, gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit pretendoi se përveç të ardhurave të siguruara nga aktiviteti tregtar<sup>22</sup> me të huadhënësit A. Ll., në vitet 2003- 2005, ka qenë dhe shpërndarës i produkteve “bio” ushqimore dhe për të provuar këtë pretendim ka paraqitur kontrata bashkëpunimit<sup>23</sup> të huadhënësit me shtetasin R. D., si dhe 5 (pesë) mandatpagesa që lidhen me këtë aktivitet.

**18.4 Komisioneri Publik**, pasi u njoh me pjesën e analizës financiare paraprake të kryer nga Kolegji për personin tjetër të lidhur A. Ll., si dhe shpjegimet e subjektit mbi të ardhurat e familjes së huadhënësit, pretendoi sa vijon.

i) Të ardhurat nga qiraja e pronave, edhe në eventualitetin e marrjes si të mirëqena të ekzistencës së këtyre marrëdhënieve dhe të ardhurave të përfituara nga to, nuk mund të konsiderohen sepse për to nuk është paraqitur dokumentacioni ligjor mbi personalitetin juridik të qiramarrësve, si edhe nuk rezulton se janë paraqitur akte për justifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të përfituara nga këto marrëdhënie. Lidhur me të ardhurat e pretenduara se janë fituar prej dhënies me qira të një objekti në bashkëpronësi<sup>24</sup> të babait të personit tjetër të lidhur I. Ll. me B. A., në vitet 1999, 2000 dhe 2001, Komisioneri Publik kërkoi që ato të mos merren në konsideratë, pasi nga aktet e administruara rezulton se babai i

<sup>20</sup> Vërtetimin e datës 14.11.2022 të lëshuar nga kompania e “{\*\*\*}” ShPK, identifikuar me NIPT {\*\*\*}, tek i cili deklarohet se: A. Ll. ka përfituar komision mbi shitjet e produkteve të lotarisë kombëtare për periudhën janar 2019 deri në shtator 2022, shumat: janar-dhjetor 2019, shumën 1.127.010 lekë; janar-dhjetor 2020, shumën 760.490 lekë; janar-dhjetor 2021, shumën 883.436 lekë; janar-dhjetor 2022, shumën 727.190 lekë.

<sup>21</sup> Vërtetimin e datës 14.11.2022 lëshuar nga “{\*\*\*}” ShA, në të cilin evidentohet fakti i përfitimit të agjentit në masën 8% të shumës totale të xhiros së kryer prej tij dhe 2% të shpagimeve, të cilat kanë qenë: 2022-2023, në shumën 3.216.000 lekë shitje; 1.071.000 lekë shpagime; (fitimi i agjentit 278.700 lekë); 2021-2022, në shumën 3.778.800 lekë shitje; 1.178.100 lekë shpagime; (fitimi i agjentit 325.866 lekë); 2020-2021, në shumën 3.899.400 lekë shitje; 1.285.200 lekë shpagime; (fitimi i agjentit 377.656 lekë).

<sup>22</sup> Të regjistruar në organet tatimore me NIPT {\*\*\*}.

<sup>23</sup> Për aktivitetin e tregtimit të produkteve “bio” nga huadhënësi subjekti, në seancën gjyqësore të datës 05.12.2022, paraqiti këto akte: (i) pesë mandatpagesa në vlerën totale të faturuar 175.000 lekë që i përkasin shërbimit të vitit 2003; (ii) kontratën e bashkëpunimit, datë 02.03.2004, të lidhur me Personin Fizik “{\*\*\*}”, fshati {\*\*\*}, Vlorë dhe A. Ll., për furnizim me produkte ushqimore të zonës për shitje, me kohëzgjatje 1 vit. Bashkëlidhur dhe katër mandatpagesa në vlerën totale të faturuar 182.000 lekë; (iii) kontratën e bashkëpunimit, datë 06.03.2005, të lidhur me Personin Fizik “{\*\*\*}”, fshati {\*\*\*}, Vlorë dhe A. Ll., për furnizim me produkte ushqimore të zonës për shitje, me kohëzgjatje 1 vit. Bashkëlidhur dhe pesë mandatpagesa në vlerën totale të faturuar 231.000 lekë; (iv) kontratën e bashkëpunimit, datë 06.03.2006, të lidhur me Personin Fizik “{\*\*\*}”, fshati {\*\*\*}, Vlorë dhe A. Ll., për furnizim me produkte ushqimore të zonës për shitje, me kohëzgjatje 1 vit. Bashkëlidhur dhe gjashtë mandatpagesa, në vlerën totale të faturuar 253.000 lekë.

<sup>24</sup> Pasurinë Nr.{\*\*\*} është truall me sip. 1,321 m<sup>2</sup> dhe magazinë artikujve sportive mbi të me sip. 882 m<sup>2</sup>, e përfituar nga blerësit I. Ll. dhe B. A. dhe me anë të kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 03.05.1996, nga Ndërmarrja e Prodhimit të Artikujve Sportive, Tiranë.

huadhënësit i ka dhuruar pjesën e tij takuese B. A., me kontratë dhurimi me nr. {\*\*\*}, datë 09.07.1996 dhe nuk ka tërhequr të drejta bashkëpronësie mbi këtë pasuri për periudhën e marrë në analizë.

ii) Për sa i përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit mbi të ardhurat e siguruara nga huadhënësi A. Ll. nga dhënia me qira e objektit banesë, të ndodhur mbrapa {\*\*\*}, si dhe objektit (dyqan), me adresë në rruga “{\*\*\*}”, për këtë marrëdhënie qiraje, Komisioneri Publik vlerëson se nga ana e subjektit nuk janë paraqitur akte për justifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të përfituara nga kjo marrëdhënie e, për pasojë, të ardhurat e siguruara prej saj duket se nuk përmbushin kriterin e konsiderimit si të ardhura të ligjshme, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

iii) Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se fitimi nga të ardhurat e aktivitetit tregtar të A. Ll., për vitet 1994-2008, duhet të llogaritet në masën 50%, Komisioneri Publik, në mungesë të paraqitjes së akteve justifikuese nga ana e subjektit mbi fitimin e pretenduar në masën 50% të qarkullimit vjetor ashtu edhe të të dhënave të konfirmuara mbi marzhin e fitimit të aktivitetit tregtar të personit tjetër të lidhur, i referohet standardit të mbajtur nga ana e Komisionit e të pranuar në vendimin e konfirmimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me llogaritjen e marzhit të fitimit, në masën 20% të qarkullimit vjetor.

**18.5** Subjekti i rivlerësimit, lidhur me qëndrimin e Komisionerit Publik të përshkruar më sipër, prapësoi si vijon.

i) Lidhur me të ardhurat e siguruara nga familja Ll. nga kontratat e qirave të viteve 1999, 2000 dhe 2001, për objektin Nr. {\*\*\*} truall me sip. 1,321 m<sup>2</sup> dhe magazinën e artikujve sportive mbi të me sip. 882 m<sup>2</sup>, me qiradhënësi B. A. (bashkëpronarin tjetër të pasurisë), subjekti i rivlerësimit pretendoi se kontrata e dhurimit të ½ pjesë takuese të kësaj prone më datë 09.07.1996 nga I. Ll., bashkëpronarit tjetër ishte një kontratë fiktive për t’i mundësuar këtij të fundit vënien e kësaj pasurie si kolateral me qëllim marrjen e një kredie. Subjekti shpjegon se kjo kontratë dhurimi nuk është zbatuar asnjëherë mes palëve dhe se sjellja e tyre në menaxhimin e pasurisë ka qenë si dy bashkëpronarë me të drejta të barabarta. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka paraqitur si provë edhe vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 00-2012-2224(374), datë 13.08.2012, me të cilin bëhet zgjidhja e pasojave të veprimtimit juridik absolutisht të pavlefshëm dhe në të cilin kërkimi i fryteve civile të lidhura me pavlefshmërinë e kontratës së dhurimit, fillonte nga data 01.05.2007, duke nënkuptuar se para kësaj date, frytet civile gëzoheshin edhe nga bashkëpronari Ll., paditës në atë gjykim, pavarësisht ekzistencës formale të kontratës së dhurimit.

ii) Në drejtim të marzhit të fitimit të aktivitetit tregtar të huadhënësit A. Ll., për vitet 1994-2008, subjekti i rivlerësimit, edhe pasi ka njohur pretendimet gjyqësore të Komisionerit Publik, i qëndroi shpjegimeve të saj se aktiviteti i huadhënësit me një natyrë komplekse të zgjeruar dhe të konsoliduar, ndër vite, duket të vlerësohet me një marzh fitimi jo më pak se 50% të qarkullimit vjetor.

**18.6** Kolegji, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, për sa i përket huadhënësit A. Ll., pasi u njoh me kërkimet përfundimtare të Komisionerit Publik, me shpjegimet dhe prapësimet e dhëna lidhur me to nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pasi administroi në cilësinë e provës aktet e sjella prej saj në mbështetje të këtyre prapësimeve, analizon sa vijon.

**18.7** Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik, se në analizën e Komisionit nuk janë përfshirë investimet e bëra nga huadhënësi A. Ll., të cilat nëse gjejnë aplikim, analiza e personit tjetër të lidhur rezulton me situatë ekonomike negative, në vijim të qëndrimit të mbajtur më sipër, për sa i përket të njëjtit pretendim të ngritur edhe në drejtim të analizës së babait të subjektit të rivlerësimit K. S., si person tjetër i lidhur, Kolegji çmon se:

Në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, edhe në këtë rast, si dhe në referim të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit<sup>25</sup>, lidhur me interpretimin e kësaj dispozite, nuk do të konsiderohet si shpenzim, me të cilin duhej ngarkuar analiza financiare e personit tjetër të lidhur A. Ll., gjendja e llogarisë bankare në Bankën Kombëtare Tregtare dhe gjendja e bonove të thesarit në Bankën e Shqipërisë në emër të këtij huadhënësi, në vlerën prej 1.305.129 lekësh. Përveç sa më lart, Kolegji vëren se edhe në rastin e analizës, për këtë person tjetër të lidhur, rezultojnë disa të ardhura të dokumentuara të krijuara prej tij dhe familjes së tij, por edhe një sërë të ardhurash të tjetra të pretenduara që vijnë si nga administrimi i ish-pronave të kthyera babait të tij e bashkëpronarëve, ashtu edhe nga aktiviteti tregtar që ky person ka zhvilluar në vite si aksionar në disa shoqëri, kuotat e të cilave i ka shitur më pas. Ky aktivitet ka zgjatur në kohë dhe kjo situatë komplekse financiare, nëse do t'i nënshtrohej verifikimit e kontrollit me të njëjtën metodologji, sikurse të ardhurat e dhëna hua, do të rëndonte në mënyrë disproporcionale subjektin e rivlerësimit, i cili do të duhej të mbante një barrë prove të rëndë e të padrejtë për llogari të procesit të saj të rivlerësimit. Për sa më sipër, ashtu si edhe në rastin e analizës së bërë për babain e subjektit, Kolegji do të analizojë në funksion të kontrollit të burimeve të krijimit të shumës prej 45.000 eurosh vetëm të ardhurat e dokumentuara e për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në raport me shpenzimet e jetesës, duke realizuar në këtë mënyrë një vlerësim të arsyeshëm e të logjikshëm në kuadër të procesit të rivlerësimit.

**18.8** Lidhur me pretendimin e ngritur nga Komisioneri Publik për të përlllogaritur shpenzime jetese jo vetëm për 1 (një) person, por për të gjithë anëtarët e familjes ndër vite, sipas përbërjes së saj, Kolegji vlerëson se është i drejtë dhe në përputhje me jurisprudencën e deritanishme të tij. Në këtë kuptim, Kolegji nuk e konsideroi të argumentuar dhe as të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se neni 32, pika 4 e ligjit, detyrimin për të provuar ligjshmërinë e shumës së dhënë hua e lidh vetëm me huadhënësin dhe jo me familjarët e tij, që në këtë rast janë persona të lidhur të personit tjetër të lidhur, me të cilët ajo nuk ka asnjë marrëdhënie, duke pretenduar se huadhënësi ka vepruar si administrator dhe përfaqësues i të gjithë familjes së tij të origjinës. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, Kolegji vlerëson se nuk do të ishte realiste dhe e arsyeshme një analizë e kryer për personin tjetër të lidhur pa verifikuar, ndërkohë, nëse familja e tij ka pasur mundësi së paku për të mbuluar kostot e jetesës, për më tepër, kur pjesë e të ardhurave, të cilat analizohen, janë ato që i përkasin të gjithë familjes, jo vetëm personit tjetër të lidhur si individ. Kryerja e analizës, duke konsideruar shpenzimet për jetesë për të gjithë familjen, në mungesë të konsiderimit si shpenzim të investimeve të tjera të kryera prej personit tjetër të lidhur, vlerësohet se përmbush nevojat e hetimit që lejojnë të shkohet drejt standardit kushtetues të justifikimit bindshëm të pasurisë së personit tjetër të lidhur.

**18.9** Në drejtim të pretendimeve të ngritura nga Komisioneri Publik, *për sa i përket rishikimit të metodologjisë së aplikuar nga Komisioni, për kryerjen e analizës financiare për personin tjetër të lidhur, huadhënësin A. Ll.*, Kolegji mori në analizë edhe qëndrimin lidhur me marzhin e fitimit të aktivitetit të tij, i cili sipas Komisionerit Publik duhet të jetë prej 20% të qarkullimi vjetor, siç ka aplikuar Komisioni, ndërsa sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit nuk duhet të jetë më i vogël se 50% e qarkullimit vjetor.

**18.10** Nga të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ prej Komisionit rezulton se huadhënësi A. Ll. është regjistruar si person fizik, me anë të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 05.11.1993, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të ushtruar veprimtari private në fushën e tregtimit të mallrave ushqimore, industriale me shumicë dhe pakicë, materiale

---

<sup>25</sup> Shih vendimin e Kolegjit (JR) 20/2019, datë 31.07.2019 [https://kpa.al/wpcontent/uploads/2019/11/Vendimi-p%  
Shih vendimin e Kolegjit \(JR\) 15/2019, datë 17.07.2019, <https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-SR-Dritan-Rreshka-i-anonimizuar-per-publikim.pdf>](https://kpa.al/wpcontent/uploads/2019/11/Vendimi-p%c3%abr-subjektin-e-rivler%c3%absimit-G.-Osmani-I-ANONIMIZUAR.pdf)

ndërtimi, elektronike, fruta perime, pije alkoolike, freskuese, bimë mjekësore etj. Më pas, me vendimin e Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 04.03.1997, A. Ll. ka zgjeruar objektin e veprimtarisë tregtare edhe në fushën e tregtimit të librit artistik, shitjes së gazetave, revistave të ndryshme, si dhe tregtimit të biletave të lotarive të fatit. Në Qendrën Kombëtare të Biznesit<sup>26</sup> (në vijim “QKB”) shtetasi A. Ll. edhe aktualisht figuron i regjistruar si person fizik, me NIPT {\*\*\*}, me status të veprimtarisë “aktiv”.

**18.11** Nga analiza e akteve dhe rrethanave që kanë rezultuar nga hetimi, Kolegji konstatoi se vendosja prej Komisionit e marzhit të fitimit prej 20% të qarkullimit vjetor të aktivitetit tregtar të huadhënësit është një nivel fitimi i vendosur apriori dhe i pambështetur në ndonjë standard ligjor, të dhënë statistikore apo studimore të fushës. Kjo normë fitimi e përcaktuar nga Komisioni, për të përlllogaritur të ardhurat e përfituara prej aktivitetit të huadhënësit A. Ll., duket se është vendosur si përfaqësuese e një norme bazike fitimi e një aktiviteti që lidhet me tregtimin e mallrave me pakicë, nivel nën të cilin kryerja këtij aktiviteti tregtar nuk do të kishte një logjikë ekonomike, e cila, gjithsesi, edhe në vlerësimin e Komisionit rezulton se ka siguruar të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e shumës prej 45.000 eurosh.

**18.12** Subjekti ka pretenduar përgjatë gjithë hetimit administrativ në Komision se fitimi nga aktiviteti i personit tjetër të lidhur nuk ka qenë më pak se 50% e qarkullimit vjetor dhe në gjykimin në Kolegj paraqiti të dhëna shtesë që tregojnë sipas saj se është arritur kjo normë fitimi përgjatë viteve. Në këto kushte, duke pasur në konsideratë rrethanat në të cilat Komisioni ka vendosur për aplikimin e kësaj norme fitimi, Kolegji analizoi të gjithë informacionin e sjellë rishitas në gjykim prej subjektit, për të konkluduar nëse kjo përqindje e aplikuar i përafrohet vlerës së përfutuar apo ajo duhet rishikuar në këndvështrim të të dhënave të reja që të çojnë drejt arsytimit që fitimi vjetor i aktivitetit të huadhënësit A. Ll. duhet të ketë qenë më i lartë.

**18.13** Në funksion të këtij arsytimi, Kolegji mori në analizë të gjithë informacionin që subjekti i rivlerësimi paraqiti në Kolegj, për sa i përket si natyrës së aktivitetit të huadhënësit A. Ll. në vitet 1993-2009, ashtu edhe fitimet e siguruar prej tij. Nga kjo analizë, Kolegji konstatoi se aktiviteti i huadhënësit nga një aktivitet i thjeshtë tregtar në fillimet e tij është shtuar me aktivitete të tjera, si ato të agjentit të shitjeve për lotaritë kombëtare apo për gazeta, libra dhe revista. Ky aktivitet, ndryshe nga ai i tregtimit të mallrave, i cili shoqërohet me shpenzime respektive për blerjen e tyre, është i përqendruar në shërbimin që kryen agjenti tregtar që ka marrë përsipër shitjen e biletave, gazetave apo revistave pa shpenzuar në vlerë monetare në këmbim të tyre, por duke përfutuar kundrejt këtij shërbimi, tarifën e komisionit/fitimit, e cila është e zhveshur<sup>27</sup> nga vlera që duhet të paguhet për llogari të detyrimeve tatimore të shlyera prej subjekteve tregtare që gëzojnë të drejtat e tregtimit të tyre. Në këtë këndvështrim, Kolegji konstatoi se aktivitetit të konsideruar prej Komisionit, për të cilin është përlllogaritur vlera e fitimit prej 20% e qarkullimit vjetor, i është bashkëlidhur në rastin e huadhënësit edhe aktiviteti i tij si agjent shitjesh së paku që prej vitit 1997, kur ai ka shtuar në objektin e tij të veprimtarisë edhe këtë aktivitet, sipas rekordeve të QKB-së.<sup>28</sup> Kolegji pati në konsideratë faktin se për vitet për të cilat subjekti ka paraqitur dokumentacion,

<sup>26</sup> <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>

<sup>27</sup> Nga dokumentacioni i sjellë nga subjekti i rivlerësimi si provë gjatë gjykimin në Kolegj, përkatësisht kontrata e bashkëpunimit me {\*\*\*} e datës 26.09.2001, përcakton se qendra i vë në dispozicion shitësit një aparat të sistemit off line, i cili shërbente, si për të kryer shitjet, ashtu edhe për të evidentuar nga qendra çdo shitje të kryer nga shitësit i autorizuar. Kjo kontratë bashkëpunimi, gjithashtu, parashikon edhe mazhin e fitimit që shitësi përfiton nga inkasimi i siguruar në vlerën total bruto nga shitja e lotarive, pasi i zbriten tatimi i TVSH dhe Tatimi i Lojërave të Fatit (TLF). Kjo shumë e siguruar nga shitja e lotarive i bashkohej aktivitetit të shitjeve të artikuljve të ndryshëm dhe së bashku përfaqësonin qarkullimit vjetor të deklaruar në administratën tatimore, për të cilat ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore, sipas legjislacionit në fuqi. Mbi këtë shumë (qarkullim vjetor), nga ana e organeve tatimore pasi aplikohet tatimi fiks, e gjithë mbetja ishte fitim i ushtruesit të aktivitetit tregtar.

<sup>28</sup> Të evidentuara në paragrafin 18.5 të këtij vendimi.



2019-2022, të ardhurat *neto* të siguruar prej kësaj veprimtarie janë të larta dhe arrijnë në ½ e vlerës totale të qarkullimit prej 2.000.000 lekësh të deklaruar si qarkullim vjetor prej huadhënësit, për shkak të regjimit fiskal të cilit ai i nënshtrohej. Në pamundësi të përcaktimit të saktë të përfitimeve të siguruara nga kjo veprimtari, për shkak të mos disponimit të dokumenteve të kohës që provojnë ato të ardhura, por në këndvështrim të fakteve se: (i) personi tjetër i lidhur ka zgjeruar objektin e veprimtarisë së tij në vitin 1997, duke përfshirë në të edhe këtë lloj aktiviteti; (ii) ka marrëveshje bashkëpunimi që datojnë që në vitet 2000, 2001 e 2002 për tregtimin e biletave të lotarive kombëtare e totogol; (iii) ka të dhëna që krijojnë një panoramë mbi fitimin e përfituar prej këtij aktiviteti<sup>29</sup>; (iv) mungesën e shpenzimeve ekstra për kryerjen e veprimtarisë si agjent shitjesh (gazetash dhe lotarish) brenda të njëjtës veprimtarie tregtare, e cila tatohej sipas statusit të personit fizik në raport me qarkullimin vjetor, i cili përmbante brenda tij edhe vlerat e përfituara prej këtij lloj aktiviteti, Kolegji konkludoi se marzhi i fitimit për periudhën e kohës gjatë së cilës personi tjetër i lidhur ka kryer këtë veprimtari duhet të llogaritet në vlerën prej 30% në raport me qarkullimin vjetor.

**18.14** Në përcaktimin e këtij raporti, Kolegji mbajti në konsideratë faktin se ndërkohë norma e fitimit prej 20% është përdorur prej Komisionit në përcaktimin e fitimit në rastet e aktiviteteve tregtare të shitjes me pakicë të mallrave, veprimtari që e ka kryer edhe ky subjekt tregtar, ka pasur raste kjo normë fitimi ka qenë edhe më e lartë<sup>30</sup>, si edhe faktin që veprimtaria që lidhet me tregtimin e biletave të lotarisë, gazetave, revistave e librave, konsiderohet si një veprimtari shërbimi, e cila, sipas një vlerësimi të gjithë pranuar, rezulton të jetë me një përqindje fitimi më të lartë se sa ajo e tregtimit, pikërisht, për shkak të faktit se kjo veprimtari ka në qendër të saj shërbimin dhe nuk ka ose ka, nivele shumë të ulta shpenzimesh për kryerjen e saj.

**18.15** Në drejtim të kostove të zhvillimit të aktivitetit, Kolegji mori në konsideratë edhe shpjegimin e subjektit se shpenzimet e huadhënësit për zhvillimin e aktivitetit kanë qenë më të pakta se përgjithësisht, pasi ai e ka zhvilluar atë në pronën e tij, fakt i cili në mënyrë të logjikshme shërben për të pasur fitime më të larta.

**18.16** Në konkluzion të sa më sipër, në mungesë të përcaktimit nga organet tatimore të marzhit të fitimit të krijuar prej aktivitetit të personit tjetër të lidhur A. Ll., për shkak të tatimit të të ardhurave të tij mbi bazën e qarkullimit vjetor, sipas fashës që tatohej biznesi i vogël/personat fizikë, sipas legjislacionit në fuqi të ndryshuar, ndër vite<sup>31</sup>, Kolegji kreu një vlerësim të diferencuar të këtij fitimi në raport me objektin e veprimtarisë së personit fizik. Kolegji, ashtu si edhe Komisioni, konsideroi si marzh fitimi 20% mbi qarkullimin e deklaruar, për vitet 1994-1996, në të cilat ky subjekt tatimor kishte si objekt veprimtarie, vetëm tregtimin e mallrave ushqimorë e industriale dhe konsideroi si marzh fitimi 30% mbi qarkullimin e deklaruar, për vitet 1997-2008, në të cilat objekti i veprimtarisë i personit fizik ishte shtuar me aktivitet shërbimesh si agjent, në fushën e shitjes së librave/gazetave e biletave të lotarive të ndryshme.

**18.17** Lidhur me qëndrimin e Komisionerit Publik, *i cili në përgjigje të qëndrimeve të subjektit të rivlerësimit kërkoi që si pjesë e analizës financiare të personit tjetër të lidhur A. Ll. të mos përfshihen të ardhurat që familja e tij ka siguruar, ndër vite, nga qiradhënia e pasurive të*

<sup>29</sup> Të përshkruar në paragrafin 18.3 pika (iv) të këtij vendimi si dhe në poshtëshënim 20 dhe 21.

<sup>30</sup> Shih vendimin [https://kpa.al/wp-content/uploads/2022/10/Vendim\\_Natasha\\_Prifti\\_perfshire\\_mendim\\_pakice.pdf](https://kpa.al/wp-content/uploads/2022/10/Vendim_Natasha_Prifti_perfshire_mendim_pakice.pdf)

<sup>31</sup> Ligjin nr. 7679, datë 03.03.1993 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”; ligji nr. 8313, datë 26.03.1998, “Për Tatimin mbi biznesin e vogël”, të ndryshuar me ligjin nr. 8715, datë 15.12.2000; ligjin nr. 881,1 datë 11.12.2001, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8313, datë 26.03.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”; ligjin nr. 8979, datë 12.12.2002, “Për disa shtesa dhe ndryshime me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998”; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 9716, datë 16.04.2007, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998”.

*paluajtshme, për ato raste kur nuk provohet shlyerja e detyrimeve tatimore, Kolegji analizon sa vijon.*

**18.18** Në drejtim të analizës financiare të huadhënësit, si person tjetër i lidhur, subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision nuk ka paraqitur të dhëna për të ardhurat e siguruara prej familjes së tij nga qiradhënia e pasurive të paluajtshme, pasi ka rezultuar e panevojshme, meqenëse siç është referuar edhe më sipër, Komisioni ka konkluduar se huadhënësi vetëm me të ardhurat e siguruara nga aktivitetit i tij tregtar provon se në vitet 1993-2009 ka pasur mundësi për të krijuar me të ardhura të ligjshme shumën prej 45.000 eurosh të dhëna hua bashkëshortit të subjekti në vitin 2009. Pasi është njohur me pretendimin e ankimit të Komisionerit Publik, se nëse në analizën e huadhënësit A. Ll. shtohen si shpenzim kostot e jetesës për të gjithë anëtarët e familjes së tij si të gjitha investimet (gjendjet e llogarive bankare), atëherë analiza financiare e tij rezulton me pamundësi për të krijuar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua prej 45.000 eurosh, subjekti i rivlerësimit, për të prapësuar këtë qëndrim, ka paraqitur gjatë gjykimit në Kolegj disa kontrata qiradhënie<sup>32</sup> të familjes Ll..

**18.19** Kolegji, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si edhe të jurisprudencës së tij të deritanishme, e konsideron një pretendim të drejtë dhe të bazuar ligjërisht qëndrimin e Komisionerit Publik, për të mos konsideruar si të ardhura, në analizën financiare të huadhënësit A. Ll., shumat e pretenduara nga qiradhënia. Kolegji arriti në këtë konkluzion, pasi analizoi me kujdes, në kuptim të kërkesave të nenit 30 dhe të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, të gjithë informacionin që sillnin kontratat e qiradhënive të familjes Ll., përkatësisht: (i) Kolegji çmoi të mos përfshijë në analizën financiare të familjes Ll. të ardhurat e pretenduara për periudhën 1996-2001, të siguruara nga qiradhënia e një magazine në “{\*\*\*}”, Tiranë, me sipërfaqe 196 m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme e truallit 1,321m<sup>2</sup>, mbi të cilën ndërtimi magazinë ka sipërfaqen 882 m<sup>2</sup>, e cila fillimisht rezulton të ishte në bashkëpronësi të babait të huadhënësit I. Ll. dhe B. A.. Kjo pasuri rezulton të ketë qenë objekt i një konflikti të zgjidhur gjyqësisht ndërmjet bashkëpronarëve përfundimisht në vitin 2012, pra, vite pas dhënies së huas nga personi i lidhur. Nga aktet gjyqësore që dokumentojnë këtë marrëdhënie, rezulton se bashkëpronësia mes babait të personit tjetër të lidhur dhe bashkëpronarit ka pushuar së ekzistuari në vitin 1996, për shkak të dhurimit të pjesës takuese. Pretendimi i subjektit, se ndonëse babai i personit të lidhur nuk ishte më pronari *de jure* i kësaj pasurie kishte mbetur bashkëpronar *de facto* dhe tërhiqte të drejtat e pronarit mbi këtë pasuri, përfshi edhe qiratë, mbeti në nivel deklarativ dhe nuk krijoi bindjen për vërtetësinë e tij. Për më tepër, lidhur me qiradhënien e kësaj pasurie, nuk provohet si përfitimi i qirasë nga familja e huadhënësit dhe as pagimi i detyrimeve tatimore. (ii) Në të njëjtën mënyrë, Kolegji vlerësoi edhe të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga familja Ll. nga qiradhënia e dyqanit, me vendndodhje pranë {\*\*\*}, Tiranë, për periudhën 1995-2007, për aktivitetin privat shitje e rregullim orësh, si dhe të një apartamenti për periudhën 1996-2008, me vendndodhje mbrapa “{\*\*\*}”, Tiranë. Për qiradhënien e këtyre pasurive, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion ligjor të kohës që provon dhënie me qira të saj dhe as përfitimin e të ardhurave dhe pagimin e detyrimeve tatimore. Deklaratat noteriale të lëshuara nga qiramarrësit e këtyre pasurive, përkatësisht: me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.01.2021, e dhënë nga A. T. për dyqanin dhe me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.01.2021, e dhënë nga B. D. për apartamentin, në referim të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, u konsideruan pa vlera të rëndësishme provuese dhe të pamjaftueshme për të bërë të mundur konsiderimin e këtyre të ardhurave si pjesë e analizës financiare të huadhënësit A. Ll..

**18.20** Në mbështetje të konkluzioneve të mësipërme, u krye në Kolegj analiza financiare<sup>33</sup> në drejtim të vlerësimit të mundësisë ekonomike të huadhënësit A. Ll. për dhënien hua të shumës

<sup>32</sup> Shih poshtëshënimin 15 tek i cili janë referuar këto kontrata qiraje.

<sup>33</sup> Analiza financiare e Kolegjit për personit tjetër të lidhur A. Ll. për periudhën 1994-2009: të ardhurat e periudhës në total 4.222.520 lekë; të ardhura I. Ll. nga statusi i veteranit në shumën 315.122 lekë; të ardhura

prej 45.000 eurosh personit të lidhur A. T.<sup>34</sup>. Nga analiza/vlerësimi financiar i kryer mbi të dhënat e mësipërme, rezultoi se personi tjetër i lidhur gjendej në pamundësi për të financuar krejtësisht shumën prej 45.000 eurosh me të ardhura të ligjshme, sipas standardit kushtetues, në vlerën prej (-) 482.464 lekësh.

**18.21** Kolegji, pasi vlerësoi këtë rezultat financiar, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, duke pasur në konsideratë një sërë faktorësh që shoqërojnë situatën e personit tjetër të lidhur, si: (i) ekzistencën e disa burimeve që kanë mundësuar krijimin e të ardhurave në vite, të cilat janë deklaruar sipas vlerësimit të vetë personit tjetër të lidhur; (ii) të drejtat pasurore mbi pasuri të paluajtshme, të cilat duket se kanë prodhuar të ardhura ndër vite; (iii) shumat monetare të depozituara në llogari bankare në vlera më të mëdha se ato të dhëna hua, kohë para kryerjes së këtij transaksioni; (iv) pamundësinë së subjektit të rivlerësimit për të provuar saktësisht normën e fitimit të personit tjetër të lidhur në kushtet e llojit të veprimtarisë që ai kryente; (v) gabime të mundshme në përlllogaritje duke qenë se personat, pasuria e të cilave është marrë në analizë nuk kanë qenë ndonjëherë mbartës të ndonjë detyrimi për deklarim, si edhe në mungesë të ndonjë indicie që e bënte të pabesueshëm ekzistencën e marrëdhënies së huas, arriti në konkluzionin se në vlerësimin e përgjithshëm të gjithë këtyre rrethanave, balanca negative e konstatuar nuk do të konsiderohet si përcaktuese për provueshmërinë e burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 45.000 eurosh dhe ajo do të konsiderohet se e kalon testin e parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

- 19** Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik *se analiza ekonomike e kryer nga Komisioni, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur, për periudhën 2003 - 2016, nga e cila ka rezultuar se subjekti është me diferencë negative vetëm për vitet 2012 dhe 2015, nuk është e plotë, pasi nuk është hetuar për të gjithë elementët e saj, që kanë të bëjnë me pagat e përfituara nga personi i lidhur, si dhe shpenzime e udhëtimit, e cila passjell, që subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet edhe për vitet 2014 dhe 2016, Kolegji analizon sa vijon.*

**19.1** Në vendimin e Komisionit, për analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, është konkluduar se: *Gjithsesi, si konkluzion Komisioni vlerëson se balanca negative e fondeve për vitin 2012, për një total të akumuluar në shumën prej 341.577 lekësh, nuk është e mjaftueshme që të sjellë aplikimin e pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 84/2016,*

---

*nga shitja e pasurive të paluajtshme në shumën 2.471.758 lekë; të ardhura nga shitja e aksioneve “{\*\*\*}”, datë 20.06.2008, në shumën 225.000 lekë; të ardhura nga shitja e apatamentit në Shkodër, datë 12.08.1996, në shumën 1.100.000 lekë; Të ardhura nga shitja e aksioneve “{\*\*\*}” ShA, datë 2.6.2008 në shumën 45.000 lekë; të ardhura nga dividenti i shpërndarë “{\*\*\*}” ShA, në shumën 29.92 lekë; të ardhura nga dividenti i shpërndarë “{\*\*\*}” ShA, në shumën 9.352 lekë; interesat bono thesari të Bankës së Shqipërisë (periudha 2002-2009), në shumën 978.035 lekë; të ardhura nga interesat BKT (periudha 2002-2009) në shumën 297.253 lekë; të ardhura nga fitimi në masën 20% të qarkullimit, për vitet 1994 -1996, në shumën 210.000 lekë; të ardhura nga fitimi në masën 30% të qarkullimit për vitet 1997-2008, në shumën 4.012.520 lekë; të ardhura nga paga, A. Ll., në shumën 855.084 lekë; pensione pleqërie për I. dhe D. Ll. në shumën 2.891.867 lekë.*

*Shpenzime të periudhës në total 13.923.347 lekë. Shpenzime për jetesë për periudhën 2000-2009 (5+1 persona në 2006), në shumën 6.816.348 lekë; shpenzime jetese në masën 66% të të ardhurave nga pensionet në shumën 363.092 lekë; shpenzime jetese 1994-1999, A. Ll. në masën 66% të fitimit të periudhës me marzhin 20% të përlllogaritur nga Komisioni, në shumën 535.709 lekë; hua dhënë bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, referuar kontratës, në vlerën 45,000 euro ekuivalent me shumën 6.208.198 lekë. Rezultati (-) 482.464 lekë.*

<sup>34</sup> Kolegji në analizën e kryer mori në konsideratë të gjithë të ardhurat e dokumentuara të disponuara në fashikullin gjyqësor. Në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti tregtar i A. Ll., Kolegji konsideroi si marzh fitimi 20% mbi qarkullimin e deklaruar, për vitet 1994-1996, si dhe konsideroi si marzh fitimi 30% mbi qarkullimin e deklaruar, për vitet 1997-2008. Në lidhje me shpenzimet, nga ana e Kolegjit u përlllogariten shpenzimet e jetesës për periudhën 1994-1999, në masën 66% të të ardhurave të përfituara nga pensioni i pleqërisë së prindërve të huadhënësit A. Ll., si dhe në masën 66% të fitimit të përlllogaritur nga Komisioni dhe për periudhën 2000-2009 shpenzimet e jetesës u përlllogariten me të dhënat e INSTAT duke konsideruar të gjithë personat e familjes së A. Ll.

*pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por duhet të jetë gjithëpërfshirës edhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.*

**19.2** Komisioneri Publik në ankim pretendon se analiza e Komisionit e kryer për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur për vitet 2012, 2014, 2015 dhe 2016 është e paplotë, pasi për këto vite nuk janë përfshirë shpenzimet e udhëtimit të familjes së subjektit dhe se nuk provohet përfitimi i pagave të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit si avokat, rrethana të cilat do të jepnin një rezultat me balancë negative edhe për vitet 2014 dhe 2016 dhe një total për një vlerë më të lartë se ajo që ka konkluduar Komisioni.

**19.3** Subjekti i rivlerësimit, lidhur me shpenzimet e udhëtimit, prapësoi pretendimin e Komisionerit Publik, duke shpjeguar se kostot e udhëtimit, për disa nga këto udhëtime, provohen nga dokumentacioni i siguruar nga agjencitë e udhëtimit, me të cilat subjekti dhe familja ka udhëtuar me paketa turistike, si dhe nga familjarët e miqtë të cilët me deklarata noteriale dëshmojnë për mbulimin e këtyre shpenzimeve.

**19.4** Në mbështetje të këtij qëndrimi, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë aktet, si më poshtë: (i) deklaratë noteriale nga L. S., me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.09.2022, me anë të së cilës deklaruesi shpreh se A. T. si avokat e ka asistuar atë në ushtrimin e aktivitetit të tij në Shqipëri dhe jashtë saj, se me familjen e tij ka marrëdhënie shumë të mira dhe se me kërkesën e tij avokati A. T., në cilësinë e konsulentit, e ka shoqëruar në disa udhëtime pune në Romë në janar të vitit 2014, në Pescara në qershor dhe nëntor të vitit 2013, në Itali. Deklaruesi konfirmon se të gjitha kostot e udhëtimit janë mbuluar nga L. S., pasi ndihej i obliguar meqenëse z. T. për shkak të miqësisë nuk e ngarkonte atë me kostot e konsulencës së ofruar; (ii) deklaratë noteriale nga A. Gj., me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.09.2022, me anë të së cilës deklaruesi shpreh se është një nga operatorët e licencuar që operon në fushën e arsimit privat (me NIPT {\*\*\*}) dhe se në muajin nëntor të vitit 2012 dhe nëntor të vitit 2014 ka kryer udhëtime për arsye pune në Austri, Republikën Çeke dhe Francë, me qëllim realizimin e kontratave të binjakëzimit të shkollave dhe, për këtë qëllim, në këto udhëtime është shoqëruar nga avokati A. T., detyra e të cilit ka qenë njohja e të kontaktuarve me legjislacionin shqiptar. Deklaruesi shpreh se kostot e udhëtimit janë mbuluar prej tij dhe meqenëse ky shërbim nga avokati T. ishte pa pagesë ka preferuar që në këto udhëtime të jenë prezent edhe bashkëshortet e tyre; (iii) deklaratë nga A. Y., rezident në Itali, e datës 26.11.2020, i cili deklaroi se A. T. dhe familja e tij janë mysafirë të zakonshëm në shtëpinë e tij në Itali dhe shpenzimet e qëndrimit janë mbuluar prej tij; (iv) vërtetim i datës 16.09.2019, i lëshuar nga agjencia e udhëtimit “{\*\*\*}”, me anë të së cilit deklarohet se shërbimet e udhëtimit (bileta dhe hotele) që familja e A. T. ka përfituar nga kjo agjenci turistike kanë të bëjnë me paketën turistike për datat 10.08.2012-17.08.2012, në shumën 600 euro dhe 2 (dy) bileta udhëtimi Tiranë-Stamboll-Tiranë, për datat 05.09.2013-08.09.2013, në shumën 300 euro; (v) vërtetim i datës 25.09.2016, i lëshuar nga agjencia e udhëtimit “{\*\*\*}”, me anë të së cilit deklarohet se A. T. ka përfituar paketa turistike të ofruara jashtë sezonit veror përkatësisht: në periudhën tetor 2012, paketë udhëtimi në Malin e Zi, Budva, me familjen me kosto 55 euro/person madhor për 2 net; në nëntor 2012 ka përfituar paketa udhëtimi në Kroaci, Dubrovnik, me familjen me kosto 79 euro/person madhor për dy net. Ky vërtetim specifikon se fëmijët nën moshën 2 vjeç, në këto paketa turistike, kanë qenë falas.

**19.5** Komisioneri Publik, pasi u njoh me analizën paraprake, kërkoi nga Kolegji të mos merren në konsideratë pretendimet e subjektit, lidhur me mbulimin e kostove të udhëtimit nga persona të tretë, për të cilët ai nuk kishte deklaruar asgjë në përgjigjet e dhëna në pyetësin standard nr. 1, të Komisionit. Mbi këtë arsye, Komisioneri Publik kërkoi të mos merren në konsideratë informacionet që japin deklaratat noteriale të lëshuara nga L. S., për një nga udhëtimet për të cilin subjekti nuk ka dhënë shpjegim në pyetësor për mbulimin e kostove, nga priti dhe A. Gj.. Nga ana tjetër, Komisioneri Publik deklaroi se e gjen të argumentuar

përcaktimin e kostove të udhëtimit, sipas informacionit të lëshuar nga agjencitë turistike, në ato raste kur në përgjigjet e pyetësorit nr. 1 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se udhëtimet janë të organizuara nga agjencitë.

**19.6** Kolegji, duke u dakordësuar me këtë qëndrim të Komisionerit Publike, reflektoi atë në metodologjinë e përdorur për përcaktimin e kostove të udhëtimit<sup>35</sup>, për vitet 2012, 2014, 2015 dhe 2016. Kolegji nuk përfshiu në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, shpenzimet për ato udhëtime që gjenin pasqyrim nga të dhënat e gjeneruara nga sistemi *TIMS*, për të cilat vetë subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar që në përgjigjet e para të dhëna gjatë hetimit administrativ se kostot e tyre ishin mbuluar nga personat e detajuar si më lart, duke i konsideruar të besueshme deklaramet e tij, lidhur me to. Kolegji nuk konsideroi si të besueshme deklaramet për mbulimet e shpenzimeve të udhëtimit nga shtetasi A. Gj., për të cilin subjekti kishte bërë deklarime rishtas në Kolegji, si edhe për një udhëtim të mbuluar prej shtetasit L. S., për të cilin nuk kishte deklarime në përgjigjet e pyetësorit të parë.

**19.7** Mbi këtë qëndrim, Kolegji, në analizën financiarë të kryer, shtoi dhe korrektoi kostot e udhëtimit të përlllogaritura nga Komisioni, specifikisht, në vitin 2012 u shtua me shumën 329.397 lekë, në vitin 2014 u korrektova vlera në shumën 539.584 lekë, në vitin 2015 u korrektova vlera në shumën 422.548 lekë dhe në vitin 2016 u korrektova vlera në shumën 760.232 lekë.

**19.8** Kolegji, gjithashtu, mori në shqyrtim edhe pretendimin e Komisionerit Publik që lidhet me pagat e përfutuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit si person fizik, avokat, në vitet 2012, 2014, 2015 dhe 2016.

**19.9** Lidhur me këtë shkak ankimi, Komisioneri Publik në ankim ka pretenduar se: *Lidhur me zërin të ardhura nga paga e bashkëshortit vlerësohet se kjo e ardhur do të mund të konsiderohet në mesin e burimeve të ligjshme të analizës financiare, në ato raste kur provohet nga subjekti i rivlerësimit se e ardhura nga paga është përfutuar/tërhequr. Rezulton se shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 30.06.2017, e ISSh-së, referon të ardhurat e deklaruara për efekt të sigurimeve shoqërore e shëndetësore si i vetëpunësuar, për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit. Nga aktet në dosje të Komisionit nuk rezulton të provohet se këto të ardhura janë kontabilizuar në zërin shpenzime të periudhës (sipas bilanceve të depozituara në dosje për vitet 2011 dhe 2012/11). Nga verifikimi i llogarive personale të personit tjetër të lidhur, evidentohen vetëm dy transaksione, në datën 10.2.2014, kreditim i shumës 100.000 lekë me përshkrimin: “{\*\*\*}”, Person Fizik, paga, si dhe në datën 13.07.2015, kreditim i shumës 80.000 lekë me përshkrimin: “{\*\*\*}”, Person Fizik, për A. T., kalime pagash. Në këto kushte, në vlerësimin e Komisionerit Publik, përveç dy shumave të mësipërme të evidentuara për vitet 2014 dhe 2015, në të ardhurat vjetore për bashkëshortin duhen marrë në konsideratë, vetëm të ardhurat e deklaruara si fitim neto vjetor i aktivitetit të konfirmuara edhe nga organet tatimore.*

**19.10** Subjekti i rivlerësimit prapësoi këtë qëndrim të Komisionerit Publik duke pretenduar se në DVP-të për vitet 2012, 2014, 2015 dhe 2016 nga personi i lidhur janë deklaruar të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit<sup>36</sup> si avokat. Referuar korrespondencës me DRT-në Tiranë, me shkresën me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.10.2019, konfirmohet se fitimi i realizuar nga aktiviteti i subjektit tatimor me NIPT {\*\*\*} është: për vitin 2012 fitimi pas tatimit është në shumën 456.367 lekë; për vitin 2014 fitimi pas tatimit është në shumën 827.398 lekë; për vitin 2015

<sup>35</sup> Të shpjeguar në vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. (JR) 11/2019.

<sup>36</sup> Nga analizimi i deklarameteve periodike të bashkëshortit të subjektit në cilësinë e personit të lidhur rezulton se për të ardhurat e siguruara nga aktiviteti i tij si avokat ka deklaruar: në DVP-në 2012 shuma neto 1.939.270 lekë; në DVP-në 2014 shuma neto 2.893.700 lekë; në DVP-në 2015 shuma neto 2.518.952 lekë; në DVP-në 2016 shuma neto 2.551.243 lekë.

fitimi pas tatimit është në shumën 824.915 lekë; si dhe për vitin 2016 fitimi pas tatimit është në shumën 1.627.976 lekë.

**19.11** Subjekti shpjegoi, gjithashtu, se e njëjta shkresë konfirmon edhe pagat, sigurimet shoqërore e shëndetësore të deklaruara e paguara nga bashkëshorti i saj si subjekt tatimor, duke u konfirmuar në këtë mënyrë edhe shifrat e të ardhurave nga paga për vitet 2012, 2014, 2015 dhe 2016, përkatësisht: për vitin 2012 të ardhura nga paga në shumën 150.510 lekë; për vitin 2014 të ardhura nga paga në shumën 161.607 lekë; për vitin 2015 të ardhura nga paga në shumën 180.328 lekë; si dhe për vitin 2016 të ardhura nga paga në shumën 521.049 lekë.

**19.12** Subjekti i rivlerësimit pretendoi se në një vlerësim të përgjithshëm të raportit të qarkullimit vjetor dhe fitimit pas tatimit të aktivitetit të personit të lidhur si avokat rezulton se fitimi zë respektivisht 24 % të qarkullimit në vitin 2012; 34 % të qarkullimit në vitin 2014; 39 % të qarkullimit në vitin 2015; si dhe 57 % të qarkullimit në vitin 2016, përqindje të cilat duke marrë në konsideratë llojin e aktivitetit të ushtruar nga bashkëshorti (shërbime në fushën e avokatisë) janë të ulta edhe në raport me atë që vetë Kolegji ka pranuar në jurisprudencën e tij në raste të ngjashme, duke aplikuar si fitim në aktivitete të kësaj natyre 80 % të qarkullimit vjetor. Subjekti i rivlerësimit vijoi analizën e saj duke shpjeguar se raporti i qarkullimit vjetor dhe fitimit *neto* të siguruar nga aktiviteti i bashkëshortit nxjerr përqindjen në masën e sipërcituar për faktin se në zërin *shpenzime administrative* janë përfshirë nga personi i lidhur edhe pagat, për të cilat janë shlyer detyrimet tatimore të konfirmuara nga kjo administratë, si dhe nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë, (në vijim “ISSh Tiranë”), sipas korrespondencës së sipërcituar.

**19.13** Si përfundim, subjekti pretendon se pagat e bashkëshortit në pasqyrat financiare të aktivitetit të tij si person fizik edhe pse janë përfshirë në zërin *shpenzime administrative*<sup>37</sup> ato janë njohur si shpenzim duke reduktuar në këtë mënyrë marzhin e fitimit dhe, për këtë arsye, subjekti kërkon që ato të njihen si të ardhura më vete nga paga e bashkëshortit. Në drejtim të vlerësimit të çështjes së pagave të përfituara nga bashkëshorti, subjekti, gjithashtu, shpjegon se: Kolegji duhet të konsiderojë se për vitet 2012, 2014 dhe 2015 nga ana e personit të lidhur si subjekt tatimor është bërë deklarimi i pagës në nivelin e pagës minimale për të cilën nuk aplikohet tatim në burim. Në vitin 2016 paga e deklaruar nga bashkëshorti i subjektit për muajt janar-shtator ka qenë në vlerën 73.800 lekë/muaj, e cila ka qenë paga minimale, sipas VKM-së nr. 37, datë 21.01.2016, e cila për muajt shtator-dhjetor 2016 u ndryshua, duke shkuar në nivelin që ishte më parë, pasi me vendimin nr. 60, datë 16.09.2016, të Gjykatës Kushtetuese u shfuqizua VKM-ja nr. 37, datë 21.01.2016, që përcaktonte një nivel të lartë page minimale për shërbimet e avokatisë. Në vijim të qëndrimit se bashkëshorti i saj, përveç fitimit nga aktiviteti i avokatisë ka përfituar edhe pagën minimale, subjekti ka theksuar se tërheqjet që ai ka bërë në bankë më 20.02.2014 në shumën 100.000 lekë dhe më 13.07.2015 në shumën 80.000 lekë, me përshkrimin *e ardhur nga paga*, përforcojnë faktin se nga ana e tij si subjekt tatimor është aplikuar tërheqja e pagës, shumë kjo e pa përfshirë dhe e pavarur si e ardhur nga fitimi që ka realizuar nga aktiviteti. Subjekti, gjithashtu, në prapësimet e saj pretendon se bashkëshorti, përveç kalimeve me përshkrim si *kalim page* nga llogaria e personit fizik te llogaria e tij personale, ka edhe shumë veprime të tjera apo tërheqje, të cilat duhen konsideruar se përfaqësojnë njësoj kalimin e pagave<sup>38</sup> edhe pse nuk kanë përshkrimin *kalim page*.

<sup>37</sup> Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit kërkoi të konsiderohet fakti se aktivitetet e kategorizuara si biznes i vogël me xhiro deri në 5 milionë në vit nuk e kanë pasur të detyrueshëm punësimin e një kontabilisti dhe, për këtë arsye, pasqyrat financiare janë plotësuar nga bashkëshorti i saj, i cili ka vlerësuar se shpenzimet e pagave të tij në kuadër të veprimtarisë së ushtruar prej tij kategorizohen si “shpenzime administrative”.

<sup>38</sup> Në parashtrimet gjyqësorë të datës 19.01.2023, subjekti i rivlerësimit identifikon se kanë të bëjnë me kalimin e pagës nga llogaria e aktivitetit tek ajo individuale e bashkëshortit, apo tërheqjet pa përshkrim për shumat, 100.000 lekë më datë 07.02.2012; 40.000 lekë më datë 17.02.2012; 40.000 lekë më datë 24.11.2014; 55.000 lekë

**19.14** Komisioneri Publik, në bisedimet përfundimtare, pasi u njoh me shpjegimet dhe qëndrimin e mbajtur nga subjekti, lidhur me pagat e përfituara nga bashkëshorti i saj nga aktiviteti i ushtruar si avokat, formuloi qëndrimin e tij në raport me rezultatin e analizës financiare paraprake të kryer nga Kolegji, duke konkluduar se: *Në këto rrethana, deklaratimet dhe të dhënat kontradiktore bëjnë të pamundur identifikimin real të pagës së pretenduar, me qëllim përfshirjen e këtyre të ardhurave në analizën financiare të viteve 2012, 2014, 2015 dhe 2016, çka do të thellonte pamjaftueshmërinë financiare përtej vlerës së llogaritur me një diferencë negative prej (-) 999.957 lekësh, të pasqyruar në analizën paraprake të Kolegjit.*

**19.15** Kolegji vlerësoi këtë pretendim të Komisionerit duke konsideruar informacionin e marrë nga shkresat e lëshuara nga administrata tatimore për Personin Fizik “{\*\*\*}”, me NIPT {\*\*\*}, që gjendeshin të administruara në fashikullin e hetimit administrativ, si dhe në fashikullin e përcjellë nga ILDKPKI-ja, përkatësisht: (i) shkresa, me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.10.2019, e lëshuar nga DRT-ja Tiranë ka konfirmuar në përgjithësi pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të deklaruara dhe paguara nga subjekti “{\*\*\*}”, me numër NIPTI {\*\*\*}, si edhe konfirmon pagën e paguar për vitin 2012, në shumën 150.510 lekë, pagën e paguar për vitin 2014, në shumën 161.607 lekë, si dhe shlyerjen e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitet 2012, 2014, 2015 dhe 2016; (ii) bashkëlidhur me shkresën e DRT-së Tiranë gjenden dhe pasqyrat financiare (bilanci) për vitin 2012, në të cilën evidentohet pagesa për sigurimet shoqërore, si dhe konstatohet se zëri i “shpenzimeve administrative” zë një volum të konsiderueshëm në raport me shpenzimet për kryerjen e aktivitetit të avokatisë. Në kushte kur ky lloj aktiviteti shpenzimet i ka në vlera të ulta në raport me qarkullimin vjetor, si edhe në këndvështrim të faktit të konfirmuar për vlerën e pagës në këtë vit nga shkresa e mësipërme e DRT-së, Kolegji e konsideroi të drejtë prapësimin e subjektit se shpenzimi për pagat gjendet i përfshirë në zërin e “shpenzimeve administrative” të deklaruara në pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve të bilancit të dorëzuar për vitin 2012 nga subjekti tatimor Person Fizik “{\*\*\*}”.

**19.16** Nga kontrolli i deklaratimeve të subjektit tatimor “{\*\*\*}”, pranë administratës tatimore, rezultoi se për sa i përket formës së deklaratimit, në ndryshim nga viti 2012, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 me ndryshimet ligjore<sup>39</sup>, biznesi i vogël<sup>40</sup> kishte detyrim të deklaronte vetëm nëpërmjet formularit të “deklaratimit të thjeshtuar”, duke plotësuar të dhëna vetëm për zërin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në këto kushte, në formularin e deklaratimit të tatimit të thjeshtuar të dorëzuar në DRT-në Tiranë nga bashkëshorti i subjektit, nuk ka informacion të detajuar lidhur me shpenzimet, pjesë e të cilave është edhe paga. Kjo mungesë informacioni që vjen për shkak të mënyrës së deklaratimit e bën të pamundur marrjen e të dhënave mbi pagat nga ky formular. Pavarësisht kësaj forme deklarimi, për vitin 2015, referuar shkresës, me nr. {\*\*\*} port., datë 23.10.2019, të DRT-së Tiranë, konfirmohet se paga e paguar për këtë vit është në masën 161.607 lekë, e dhënë e cila konsiderohet nga Kolegji në koherencë edhe me deklaratimet e vetë subjektit tatimor në deklaratat e tatimit të thjeshtuar.

---

më datë 04.06.2015; 60.800 lekë më datë 09.11.2015; 80.000 lekë më datë 10.05.2016 dhe 70.000 lekë më datë 22.07.2016.

<sup>39</sup> Në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 32, datë 31.12.2013, të miratuar në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, në pikën 9 “Deklarimi” përcakton mënyrën e deklaratimit të çdo tatimpaguesi, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, duke specifikuar se këto subjekte kanë detyrimin të dorëzojnë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat gjithësej, shpenzimet e zbritshëm, e ardhura e tatueshme dhe tatimit për t’u paguar. Në rastin objekt shqyrtimi, subjekti Person Fizik “{\*\*\*}”, nga praktika e sjellë nga DRT-ja Tiranë, rezultoi se për vitet 2014, 2015 dhe 2016 janë sjellë formati i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin i plotësuar nga ky subjekt sipas modelit/formatit të kërkuar nga udhëzimi nr. 32, i datës 31.12.2013, në këto formularë deklarimi subjekti tatimor ka deklaruar të ardhurat, shpenzimet, fitimin e tatueshëm si dhe tatimin e thjeshtuar mbi fitimin.

<sup>40</sup> Shih udhëzuesit e Ministrisë së Financave për tatimpaguesit “Person fizik: me xhiro mbi 2 milionë deri në 5 milionë lekë: <https://www.tatime.gov.al/c/317/319/348/person-fizik-2-deri-ne-5-milion-leke>.

**19.17** Përveç sa më sipër, nga rekordet bankare të pohuara edhe prej Komisionerit Publik, rezulton se ka tërheqje bankare të bashkëshortit me përshkrim *paga* në shumën 100.000 lekë, për vitin 2014 dhe 80.000 lekë për vitin 2015, si dhe ka tërheqje të tjera bankare pa përshkrime të veprimeve, të cilat subjekti i rivlerësimit pretendoi, gjithashtu, se janë tërheqje page nga bashkëshorti i saj.

**19.18** Gjithashtu, Kolegji mori në konsideratë edhe të dhënat e shkresës, me nr. {\*\*\*} prot., datë 30.06.2017, të lëshuar nga ISSh-ja Tiranë, për Personin Fizik “{\*\*\*}”, në të cilën konfirmohen të ardhurat financiare të pagës *bruto* dhe *neto* të realizuar prej tij për vitin 2012 në shumën 150.510 lekë; për vitin 2014 në shumën 121.005 lekë; për vitin 2015 në shumën 185.328 lekë; si dhe për vitin 2016 në shumën 521.049 lekë. Për vitin 2016, lidhur me pagat e përfituara nga bashkëshorti, subjekti gjatë shqyrtimi gjyqësor të çështjes pretendoi për muajt janar-shtator ka qenë në vlerën 73.800 lekë/muaj, e cila ka qenë paga minimale, sipas VKM-së nr. 37, datë 21.01.2016, e cila për muajt shtator-dhjetor 2016 u ndryshua<sup>41</sup>, duke shkuar në nivelin që ishte më parë. Këtë pretendim të subjektit, për pagën minimale të vitit 2016, Kolegji e konsideroi si jo të drejtë dhe të argumentuar ligjërisht, pasi paga në vlerën 73.800 lekë/muaj referuar legjislacionit në fuqi përfaqësonte pagën minimale të profesionit të avokatit dhe jo pagën minimale në nivel të pa tatueshëm, pra, të përjashtuar nga pagesa e detyrimeve tatimore, e cila në vitin 2016 ishte në vlerën 30.000 lekë/muaj.

**19.19** Në përfundim, lidhur me shkakun e ankimit të ngritur nga Komisioneri Publik në drejtim të provueshmërisë së përfitimit të pagave nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, Kolegji vlerësoi në tërësi të gjithë informacionin e marrë mbi pagat e përfituara nga bashkëshorti i subjekti si person fizik, që gjendeshin në pasqyrën financiare, të viti 2012 si dhe në deklaratat e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të konfirmuara nga organet tatimore, të sigurimeve shoqërore, si dhe në informacionin e ofruar nga të dhënat bankare. Nga analizimi i tyre në mënyrë integrale dhe të harmonizuar, Kolegji arriti në konkluzionin se dukej i besueshëm pretendimi i subjektit të rivlerësimit se bashkëshorti i saj i kishte përfituar realisht pagat në kuadër të aktivitetit të tij dhe për të cilat ishin paguar detyrimet e kërkuara nga ligji. Përveç konfirmimeve të organeve tatimore e të sigurimeve shoqërore, si edhe deklaratimet e subjektit tatimor për shpenzime të larta brenda aktiviteti që nuk ka tipikisht të tilla shpenzime, si edhe përshkrimet në tërheqjet bankare të paktën për vitet 2014 e 2015, si tërheqje nga paga, të krijojnë besueshmërinë se përfitimi i pagës, edhe pse nuk ka qenë një zë në deklaratat e të ardhurave dhe shpenzimeve, është përfituar realisht nga bashkëshorti i subjektit. Ky qëndrim vjen në harmoni edhe me faktin se fitimi i deklaruar prej bashkëshortit për këto vite do të rezultonte në vlera shumë të ulta, larg normës së fitimit të konsideruar si rregull edhe prej Kolegjit në raste të tjera të realizuara nga ky lloj aktiviteti. Në mbështetje të këtij arsytimi, Kolegji e kreu analizën financiare të viteve 2012, 2014, 2015 dhe 2016, duke përfshirë si të ardhur nga paga e bashkëshortit të subjektit vetëm pagën minimale në nivel të patatueshëm në secilin nga këto vite. Pavarësisht këtij arsytimi, Kolegji konsideroi edhe një version të analizës financiare duke mos përfshirë të ardhurat nga paga e bashkëshortit të subjektit për vitet në fjalë dhe konstatoi se ndonëse balanca negative rritej, në raport me atë që rezultonte me pagat e përfshira si të ardhura, përsëri ajo nuk ishte e tillë që të ndryshonte vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

**19.20** Përfundimisht, lidhur me kërkimin e Komisionerit për ribërjen e analizës financiare<sup>42</sup>, për subjektin e rivlerësimit dhe familjen e saj për vitet, 2012, 2014, 2015 dhe 2016, Kolegji e

<sup>41</sup> Me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 60, datë 16.09.2016, u shfuqizua VKM-ja nr. 37, datë 21.01.2016, që përcaktonte një nivel të lartë page minimale për shërbimet e avokatisë.

<sup>42</sup> Analiza financiare, për vitet 2012, 2014, 2015 dhe 2016, u kryer sipas metodologjisë së Kolegjit. Për vitin 2012, në rezultatin e analizës financiare të përlllogaritur nga Komisioni, në vlerën (-) 341.577 lekë nga analiza e kryer në Kolegj, u shtuan shpenzimet e udhëtimit me shumën (+) 329.397 lekë, u korrektuan shpenzimet e jetesës në vlerën (+) 5.904 lekë, u korrektuan të ardhurat nga paga me shumën (-) 95.010 lekë, u korrektua



kreu atë duke konsideruar pretendimet e Komisionerit Publik, lidhur me pagat e bashkëshortit të subjektit nga aktiviteti i avokatisë për këtë periudhë dhe lidhur me rillogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit. Duke konsideruar qëndrimin e Komisionerit Publik në konkluzionet përfundimtare se pagat mbeten në një version garantist, të papërcaktuara, për shkak të mospërputhjeve mes të dhënave të hasura në aktet e administruara, Kolegji i konsideroi ato në analizën financiare në vlerën e pagës minimale, sipas përcaktimeve ligjore të ligjit nr. 9766, datë 09.07.2007, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar” dhe të ligjit nr. 177, datë 28.12.2013, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, e cila është e përjashtuar nga pagimi i tatimit dhe për të cilën rezultojnë të jenë paguar detyrimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Kolegji korrektoi, gjithashtu, zërin e analizës financiare që lidhej me shpenzimet e udhëtimit, sipas qëndrimit të Komisionerit Publik, mbështetur në të dhënat e vërtetimeve të lëshuara nga agjencitë e udhëtimit dhe përlllogaritjes, sipas metodologjisë së aplikuar nga Kolegjit në rastin e udhëtimit në vitin 2015, në të cilin, bashkëshorti i subjektit është akomoduar te shtetasi L. S.. Sipas kësaj analize, subjekti i rivlerësimit rezultojnë në një balancë negative prej (-) 872.576 lekësh e shtrirë në të katër vitet e sipërcituara. Balanca negative do të thellohej në versionin që pagat e bashkëshortit nuk do të konsiderohen si të përfituara në këto vite, po përsëri në një vlerë që në vlerësimin e Kolegjit kishte të njëjtën peshë në afektimin e kriterit të pasurisë si ajo e konkluduar më lart.

**19.21** Kolegji vlerësoi mungesën e burimeve të ligjshme në vlerën prej (-) 872.576 lekësh, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe të proporcionalitetit dhe në konsideratë të faktit se kjo vlerë shpërndahet në disa vite në vlera jo domethënëse. Kjo balancë negative nuk u vlerësua se duhet të krijojë një përgjegjësi disiplinore për subjektin e rivlerësimit, për pasojë, Kolegji arriti në konkluzionin se subjekti ka nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

20. Kolegji nuk ia nënshtroi shqyrtimit të tij, shkaqet e tjera të ankimit, të cilat në bisedimet përfundimtare, pas zhvillimit të hetimit e debatit gjyqësor, u konsideruan të provuara prej Komisionerit Publik e, për pasojë, mbeten jashtë objektit e kufijve të shqyrtimit të çështjes.
21. Në përfundim, Kolegji, në vlerësim dhe analizë të konkluzioneve të mësipërme dhe të konkluzioneve të Komisionit, për kriterin e kontrollit të figurës e kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, çmon se vendimi nr. 264, datë 17.06.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Elona Toro, është marrë në vlerësim të drejtë të fakteve e provave të administruara gjatë hetimit e në zbatim

---

*gjendja e llogarive bankare në fillim të vitit me shumën (+) 196.819 lekë, si dhe u korrektova gjendja e llogarive bankare në fund të vitit me shumën (-) 1.817 lekë. Rezultati i analizës financiare për vitin 2012 është (-) 573.252 lekë.*

*Për vitin 2014, në rezultatin e analizës financiare të përlllogaritur nga Komisioni, në vlerën (+) 137.694 lekë, nga analiza e kryer në Kolegj u shtuan shpenzimet e udhëtimit me shumën (+) 175.220 lekë, u korrektovan të ardhurat nga paga me shumën (-) 68.605 lekë, si dhe u korrektovan shpenzimet për sigurimin në shumën (+) 4.864. Rezultati i analizës financiare për vitin 2014 është (-) 111.019 lekë.*

*Për vitin 2015 në rezultatin e analizës financiare të përlllogaritur nga Komisioni në vlerën (-) 28.588 lekë, nga analiza e kryer në Kolegj, u shtuan shpenzimet e udhëtimit me shumën (+) 79.348 lekë, u korrektovan të ardhurat nga paga me shumën (-) 78.672 lekë si dhe u korrektova gjendja e llogarive bankare në fund të vitit me shumën (-) 1.697 lekë. Rezultati i analizës financiare për vitin 2015 është (-) 188.305 lekë.*

*Për vitin 2016 në rezultatin e analizës financiare të përlllogaritur nga Komisioni në vlerën (+) 523.816 lekë nga analiza e kryer në Kolegj, u shtuan shpenzimet e udhëtimit me shumën (+) 16.467 lekë, u korrektovan të ardhurat nga paga me shumën (-) 526.035 lekë si dhe u korrektova gjendja e llogarive bankare në fund të vitit me shumën (-) 4.697 lekë. Rezultati i analizës financiare për vitin 2016 është (-) 13.989 lekë*

*Subjekti i rivlerësimit rezultojë në një diferencë negative për të gjithë periudhën në shumën (-) 872.576 lekë.*

të drejtë të dispozitave ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit. Si i tillë ai konsiderohet edhe pas këtij gjykimi dhe, për pasojë, duhet të qëndrojë në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 264, datë 17.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Elona Toro.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 02.02.2023

#### **ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUES**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*